PËLLUMB KULLA

Rrëfenja nga Amerika

BOTIMET TOENA

“RrËfenja nga Amerika”

-Përjetime dhe portrete shqiptarësh në mërgim-

Pëllumb Kulla

TOENA, Tirane 2011

ISBN: 9789994316922

Rrëfenja e parë: - Ja bre, kjo është Amerika! 4

Rrëfenja e dytë: - Kur mos kem mamanë! 10

Rrefenja e trete - Një nuse shqiptare rrëmbehet në Nju Jork 16

Rrëfenja e katërt: Një politikan i Tiranës vjen në Uashington 22

Rrëfenja e pestë: Takim me dy gogolat e parë sa shkel në Amerikë 29

Rrëfenja e gjashtë: Urat që të shpien në Menhetten 35

Rrëfenja e shtatë: Përse të akuzoja atëhere, or më qafsh?! 40

Rrëfenja e tetë: Ca fiq për një kitarë xhazi 47

Rrëfenja e nëntë: Si fsheha mes shalëve dyzetetremijë dollarë 54

Rrefenja e dhjetë: Presidenti i Amerikës apo guvernatori i Nebraskës? 67

Rrëfenja e njëmbëdhjetë: Në pritje për një burrë amerikan 72

Rrëfenja e dymbëdhjetë: çlirimi i Nju Jorkut nga gjermanët 77

Rrëfenja e trembëdhjetë: Hije në Filadelfia 83

Rrëfenja e parë: - Ja bre, kjo është Amerika!

Tëmën bre, prefesor, - nis ligjëratën e përditshme shoferi, - sa llafe të ndyra

kishmë dëgjuarë për Amerikën! Po na kishnë thënë-o, se këtu n'Amerikë njeriu shfrytëzohet pe njeriut. çne bre! Mbroçkulla! Këtu, or byrazer, ndodh e kundërta!

Radha e veturave në portat me pagesë të Trajboro Brixhit është e gjatë.

Megjithatë unë kam kohë deri në fillimin e punës. Tej mbi Menhetten, që e kemi në krahun e djathtë, kanë rënë rrezet e para të diellit dhe kjo kartolinë e rrallë e shtyn mikun tim Peçon, ashtu me duar mbi timon, të më bëjë një raport përmbledhës me përshtypjet e tij nga Amerika. Ai e ndjen që unë i dua rrëfenjat e tija në atë gjuhën dialektale korçare, rrëfenja që më zbavisin pa masë dhe nuk shterrin kurrë.

Ikë sa të duash larg, ore, - vazhdon Peçoja, - mendjen në Shqipëri do ta kesh! Një sy këtu e dy atje. Unë atje kam pleqtë, siç i ke dhe zotrote. Edhe shokët e kushurinjtë e mij, pleqtë i kanë në Shqipëri... Mendjen atje e kemi të tërë. Sa bie telefoni, i pyesim: Keni korent-o? Po ujë? Si jeni me drita mo?

Kemi qëndruar tek njëra nga kabinëzat mbi urën e Trajboros dhe Peçoja më zgjat dorën. I jap paratë për kalimin e urës, ai paguan, hapet trari dhe makina vazhdon rrugën për Kuins.

Ja kështuuuu, prefesor! Jetojmë kohëra të mrekullueshme, kur ne shqiptarët e ardhur këtej, shumica mosha të reja, kemi lënë atje prindërit, pleq e plaka, që të na e bëjnë edhe njëherë elektrifikimnë e përgjithshmë!

Me Peçon, vendet e punës i kemi pranë e pranë. Vetura është e tija, kurse pagën e urës e bëj unë. E ai më shpie në punë çdo ditë. Ai më shpie edhe tani që puna e tij ka një rënie. Punon në një kompani taksish dhe limuzinash, por kur shterrin pasagjerët Peçon e kanë nga

të parët që pushojnë. Po ai nuk e prish terezinë. Paraqitet në mëngjes e pastaj kur i thonë që nuk ka punë për të, futet në një kafe në Kuins e pret t'u bëjë ndonjë shërbim me pagesë shqiptarëve me makinën e vet.

Unë punoj në një Strehë, ku rehabilitohen fëmijë me të meta, kryesisht jetimë. Streha është e mbajtur mirë e financuar pjesërisht nga shteti i Nju Jorkut dhe më së shumti nga dhurues kristianë. Po Motër Gjenovefa është aq e zonja, sa shpesh arrin të marrë financime edhe nga qeveria federale. Ajo e ka themeluar vetë Strehën e tani fluturon nga krenaria që Streha e saj është bërë model. Unë aty organizoj argëtimet e fëmijëve dhe mbaj gjallë grupin e theatrit. Motër Gjenovefa që ka sjellë për vete një krevat të thjeshtë e fle aty në Strehë, rri orë të tëra duke parë inskenimet e mia mbi fëmijërinë e Linkolnit, Presidentit të lavdishëm të Shteteve të Bashkuara.

Puna më ecën edhe më vjen keq që shokut tim Peços nuk i vete mbarë sikurse mua. Nganjëherë më duket se ai e di që atë ditë nuk do të ketë punë as me taksi as me limuzinë, por vjen, ja thjesht që të më bëjë lehtësi mua. E gjatë gjithë rrugës së gjatë nuk lodhet duke folur. Shpesh them që do t'ia mbledh këto rrëfenja. Jam i bindur që do t'i kujtoj të gjitha një e nga një ato që më ka treguar deri më sot. Janë tregime të jetuar nga ai vetë, por ka plot nga të shqiptarëve të tjerë, pasagjerë, që ia rrëfejnë rrugës dhe ai m'i sjell mua taze, të ngrohta. Jam kureshtar të di, se çfarë u rrëfen ai të tjerëve për mua. Se nuk mund të rrëfesh asgjë për një njeri si unë, që rri gojë kyçur e vetëm qesh hera -herës duke dëgjuar shoferin gojë kripur, që nuk lodhet kurrë së rrëfyeri. E flet e flet… Ja si tani:

Rrimë këtu në Amerikë e ndjekëm me drithërimë të tëra kacafytjet dashamirëse

të politikanëve atje, të cilave y thonë "kacafytje për të gjetur unitetnë", unitet që nuku vjen, ce është nisur ters… Po është nisur ters bre, që në përçapjen e parë të Skënderbeut. Se ay e bëri me ugur të keq, o prefesor, qëkur për t'i bashkuarë shqiptarët, zgjodhi për kuvënd Lezhën, që atëherë quhej Lesh!..

Shoferi u jep një të fshirë xhamave, megjithëse ata mua më duken më të tejpashëm se kurrë.

- Ka shumë vjedhje në Shqipëri, thonë, korrupsion. Qeveritarët e politikanët e kanë mendjen te paraja. Si e si, të bëhen milionerë! Prandaj është më mirë bre, kur shtetin e drejtojnë të ngopurit, pasanikët. Këtë po përpiqen të realizojnë partitë në Shqipëri. Që shtetin ta drejtojnë të pasurit, ka dy rrugë, prefesor: ose të pasurit të bëhen ministra, ose ministrat të bëhen të pasur! Në mëmëdhe po ndodh kjo e dyta; ministrat po bëhen të pasur!… Prandajza sa herë vete andej-këtej y them shqiptarëve, kudo që janë: vëllezër

Filadelfiotë, Vaterburas, Njuxhersjotë, Bostonianë, Detroitjotë, çikagas, të ini krenarë për mëmëdhenë e dashur ore! Atje në mëmëdhe, vjedhjet kanë qëllime të pastra, fisnike. Atje vjedhin për pikësynime të nderçme… Njëherë vaftit, shteti i rripte lëkurën individit për të mirë të përgjithshme, sot për të mirë të tij, individi i rrjep lëkurën e përgjithshme shtetit.

Peçoja vështron ca vrapues shalëjashtë, që ndjekin paralel veturën në të dy anët e rrugës. Një burrë i ngjallmë mezi i lëviz kilet e tij e duket aq i rraskapitur, sa të bësh be se ky është vrapimi i tij i fundit para se ta varrosin.

- Sa e kishmë ëndërruarë Amerikën, o prefesor, ëh?… Këtu shëndoshesh, fryhesh pa dashur, o në p.. të sëmës! Ma shëkon ti prefesor, barkun, mullën time? Asnjë thërrimë dhjamë, as një çiçkë bark nuk kam patur në Shqipëri! Xhan o ushqim i Shqipërisë! Bëj unë tashi vrap, që të ul barkun, por varet e nga puna, bre. Se nuk është fizkultura kryesorja. Më parë, këtu, bënja gjashtë ditë punë, po ama, një ditë ia linja të tërën, vrapit. Nuk do linja punën për të vrapuar de! Pastaj ra puna. Fillova të bëj pesë ditë punë e dy ditë vrap… Pastaj .. m'u shkurtua akoma puna e fillova të bëj tri ditë punë e katër ditë vrap. Tani ka një muaj, bëj vetëm … vrap!

Dhe miku im nuk ka të rreshtur:

- Po sikur është vetëm ky hall këtu! Mua nuk më janë ndarë hallet, qëkur vura këmbën. Pa gjuhë, bre, pa gjë… Dy vitet e para punova pa letra, fshehur. Punonja në kat të gjashtë po së prapthi, gjashtë kate dënë dhe! As e pashë diellin as më pa! Nuku se amerikanët janë të rreptë, po kisha akoma në palcë të dredhurat e Selanikut. Këtu, shokët e mij… ezmerë, - se mo na e marrin amerikanët për racizmë! ata ezmerët dilnin e më blinin për të ngrënë, ata më mësonin zanatnë, gjuhën. Ja atje thellë, ku isha, e mësova gjuhën e vëndit, gurgull! Pas dy vjetësh, kur dolla mbi trotuaret lart, e mora vesh e xheç më ra dambllaja: gjuha që paskësha mësuar bilbil, nuk paskej qënë anglisht, o prefesor, po… spanjollçe oreee!!! Kur mos kem mamanë! Po si ore asnjëri nuk më tha, se ata hushkulurit ezmerë, kishin qënë nga Porto Rikua! Më shkuanë dy vjet. Fillova anglishten nga e para. Zhytem po s'mbytem unë!. Ama, thuaj hë, gjuhë më të zorçme, nuk bën nëna! Për të folur, hajde de, pa për të shkrojtur, po nuk vajte në shkollë, aha, harro mushkë…! Amerikanët, or byrazer, e shkruajnë "mace" dhe e lexojnë "qen"! Fëmijët venë në shkollë dhe e mësojnë, ne të rriturit, hiç-o, ç'të na vijë nga veshi. E kështu shtyhemi. Papo, është e bukur bre, kur e dëgjon tjetrin ta bëjë mishmashnë në mes të supermarketit, t'i thotë së bijës: "Na moj ti dhi e Ziçishtit! Mo më thuaj aj dont kerë, po mbylle grykën, ce të futa një pëllëmbë të mirë, sa të harrosh pasuordin e internetit dhe gjer bë dhjetë numëra celularësh!"…

Peçoja e le tregimin dhe drejton gishtin nga një veturë që po na le pas.

Shëko, shëko!.. E pe atë Mercedesnë? Ia pe flamurë tonë mbi targët?

Ia pashë. i them unë.

Gjen këtu dhe shqiptarë që të marrin gjak në vetull. Fitojnë dhe e derdhën paranë lumë. vazhdon Peçoja. Njëdizaj, një i njohuri im-njëherë vaftit bëmim zborë bashkë me të, - blevi një shtëpi një milion dollarë. Kur mos kem babanë! Saktësisht: një milion dollarë e 99 cent! Gjen bre këtu shqiptarë që hapin biznese, si ata devollinjtë që kishnë hapur një servis veturash dhe kishnë marrë me mëditje vetë amerikanët! Amerikanë bre, orgjinalë, kur mos i kem tërë! Dhe bile y mësojnë atyre korçarçen tonë. Ja, u ngëtheva nga një vizitë në Shqipëri unë, e vajta e po y rrëfenja devollinjve ç'kisha parë në mëmëdhe. Por më shumë u trondit pe atyre që rrëfenja unë, ay amerikani zezak, që punonte për ta. Me gojë hapur kamare pe habisë, dolli që poshtë maqinkës që po riparonte e më tha: "Me gjith mënt "o? Ik or t'u mbylltë e mëndjes", - ia bëri zezaku, -" ce nuku t'i ha njeri këto!?!"- " Kur mos kem babanë!" i thashë. "Kur mos kem babanë, edhe unë s't'i besoj!" ma previ zezaku dyke zënë be për babanë zezak!

Në një udhëkryq të Kuinsit, dy policë amerikanë me fytyra kinezësh, po i jepnin radhë trafikut. Unë vura bast me veten se Peçoja tani do të hapte bisedë mbi kinezët. Dhe e fitova bastin:

Nganjëherë nuk e merr vesh je në Amerikë apo gjëkundi tjatër!.. "hap temën tjetër Peçoja. - Dhuratat që shqiptarët, blenë për të dërguar në Shqipëri, të gjitha mbajnë etiketën e prodhimit Made in China! Po sikur na kanë mallkuarë, që të mos na ndahet Kina kudo që të vemë, or tëmën e sëmës!… Ore, amerikanët si sistem, fituanë mbi komunizmën, po si shpërblim e panë ç'y erdhi: iu mbush vendi me.. me… rusë-do ti a, polakë-do ti a, shqiptarë- do ti! Edhe një fitore kështu mbi Kinën y duhet këtyre e pastaj, që të shohç një amerikan, do të duhet të shkosh në rezervuaret e indjanëve! Edhe atje edhe jalla, kur ta gjesh! Ja kur mos kem mamanë në e tepëroj! Do të ma shohç pastaj Amerikën! Hë-hë-hë!… Po amerikanët janë të mençëm, ore, dhe tashi kanë filluarë ta kuptojnë mirë, se të drejtat e njeriut në Kinë, nuku janë edhe aq keq or jo!...

Arritëm përpara Strehës. Peçoja nuk kish më kohë të përfundonte të tërë temën e kinezëve, të filipinëve, rusëve… Por, ja, kemi ditët e tjera që vijnë. Dhe unë mahnitem sa mirë i zbërthen Peçoja vuajtjet, lumturitë e peripecitë e shqiptarëve të mërguar në këtë tokë të Amerikës, në mes të këtij oqeani mërgimtarësh nga e gjithë bota….

Rrëfenja e dytë: - Kur mos kem mamanë!

Nëse mund t'i themi ende djalë një dyzetvjeçari, vetëm se i ka faqet e kuqe dhe një dritë gazi që nuk i ndahet nga sytë, Peçoja është djalë, madje një djalë i këndshëm. Ai gërmon, nxjerr e na ve përpara gurë të çmuar nga përjetime të të tëra llojeve: që nga një periudhë burgu, një punë e vështirë në parkun e mallrave të Korçës, një dalje dyvjeçare në rrethinat e Selanikut dhe një hyrje e mundimshme në Amerikë, me ndërmjetësinë e kurbetlinjve të vjetër korçarë. Këtu punoi ca kohë si shofer brenda oborrit të një firme italo-amerikanësh, të cilët ia lejojnë vetes të marrin në punë një mërgimtar, që ende nuk i ka letrat nga autoritetet vendëse. Por nuk e linin Peçon të kalonte kurrë me kamion pragun e portës së oborrit të tyre. Tej pragut, pushteti i punëdhënësve italianë merrte fund.

Tani banon pranë nesh në Mosholu Park, Norvud, Nju-Jork…

Stacioni i parë i vizitave në shtëpinë time për të është rafti i librave. Edhe pse lexon për bukuri Tajmsin, pa thënë që ka një etje të pashuar për gjithçka botohet në atdhe, gjuha e Peços ruan koloritin e fshatrave të Fushës së Korçës ku edhe është lindur. Ai mendon se vetëm kështu mund të ngjitin më mirë rrëfenjat e tija. Unë them se e bën më shumë që të mos harrojë ta përdorë atë me bujtësat e tij, kurbetlinjtë e vjetër, të cilëve ajo gjuhë u ka mbetur ashtu, pa pasur ata asnjë mundësi e pa ndier asnjë nevojë për një përshtatje më bashkëkohore.

Rrëfenjat e Peços janë gazmore e, nganjëherë, ai më ngjan si një korrespondent i dërguar në burgun e diktaturës e në qarqet e mërgimtarëve shqiptarë të Selanikut, të Bostonit dhe të Nju-Jorkut, nga ku reportazhet e dhembjes, mendon ai, janë bërë tashmë shumë. Ai duket sikur ka zbritur poshtë të gjuajë karaktere e ndodhi që të bëjnë të mendosh se asnjëherë jeta nuk është vetëm e vështirë.

Nga kjo Peçoja duket pak i lehtë dhe jo aq serioz. Sidoqoftë, gjuha e tij na është bërë si epidemi e këndshme, sa edhe unë e zë veten duke i thënë:

Ce bre Peço? Po ce o derëzi? Po ti qenke i lojtur o t'u mbylltë!

Aty edhe ime shoqe po më pyet me "ce o burrë", ndërsa fëmijët kanë harruar të betohen si më parë dhe tani të sigurojnë duke përdorur betimet e Peços: "Kur mos i kem të tërë!" ose, edhe më prekshëm, me atë "kur mos kem mamanë!"

Kur na vjen për vizitë, ai nuk e ka për gjë ta lëshojë gojën edhe në prani të gruas sime. E pastaj nxiton t'i kërkojë asaj të falur duke e

siguruar se ushqen për të respekt.

Për shkarjet e gojës, gjithë fajin, sipas tij, ia ka qyteti ku është rritur.

Ama, vërtet bre, kush i njeh mirë korçarët, - shfajësohej një ditë Peçoja, - nuk ua merr për keq. Shko në Pazar të Korçës, brenda orës dëgjon më shumë të shiten nga ato .. të nënave, se piperka e domate! Kur të qaj mamanë, çapëlojnë sytë e gojën të tërë ata që zbresin për herë të parë Korçë e dëgjojnë: "T'ëmën! Po ç'bëhet kështu or q..fjaj t'ëmën! Pat erdhur një herë një shkodran me shërbim, në Grumbullim të Korçës, siç vinte pe vitesh. Këtë herë qëllovi që shefit të një reparti, një natë më parë i kish vdekur babaj. Do vinin ta ngushëllonin shokët e punës e ay shkodrani i shërbimit kish thënë: "Po vij dhe veta!" Po juve e kuptoni tani sesi mbeti ay, kur i dëgjonte korçarët ta ngushëllonin shokun e tyre: "T'ëmën bre Kiço, po babaj vdiq o në p… të s'ëmës, ëh?" Shkodrani nuk u besonte veshëve. "Janë çmendur këta",- thoshte me vete. Fillonte i dyti: " Po kur vdiq, bre Kiço?" "Sot më të gdhirë" ia kthente Kiçua. " Paaa! Si bre më të gdhirë?! E po m'i hëngsha t'ëmën, vdekja të merr kur t'i dojë bytha!" Varda goja ore! Kur mos kem mamanë! Fillonte i treti: "Kur e kini lënë varrimnë, o Kiço?" " Më tre pas dreke" " Më tre, ëh? Hiçgjë nuku jemi bre! Sot mbi dhÃƒª, nesër dënë dhÃƒª, o më i ..fsha t'ëmën vdekjes! Ta thosh veç njëri, e po hajde de! Po tërë gojë prishur, tërë me të shara nga nëna! Shkodrani i dha karar: kjo gojëprishje ishte pe atyre riteve që nuku ia njohim njëri-tjatrit e mendovi se korçarët gjithë këto, i kanë kundër mortjes. I erdhi radha atij vetë tashi. Juve e përfytyroni të gjorë shkodran, me zë të bukur, i sjellçmë, delikat, që po matej të kapërcente një ledh që s'e kish hedhur ndonjëherë. Djersët çurkë e nuk dinte si ta niste me Kiçon: t'i shante më parë nënën apo t'i thosh udhë e mbarë babajt?!…

Ne qeshnim duke fshirë lotët, kurse Peçoja na siguronte, se të tëra këto ishin të vërteta.

Kur mos kem mamanë, në ju gënjej!

E ky ishte betimi i fundit i Peços me mamanë e tij. Atë betim ai nuk e përdor më.

Katër ditë më pas Peços i vdiq e ëma. Në fillim e lajmëruan se ajo, befas, qe sëmurur rëndë. Atë ditë unë i vajta në dhomë dhe e gjeta Peçon në lot. Nuk e kisha parë të përlotur më parë dhe nuk e kam parë më që ato ditë.

Ai më bëri shenjë të hiqja pallton dhe vazhdoi të dëgjonte ato që i rrëfente në telefon e motra që pati lënë Tiranën dhe kishte nxituar në fshat, ku banonin pleqtë. Pastaj, miku im la telefonin dhe u ul në një

kulltuk të vjetër.

Mamaja po na le, - tha me zë të shuar. Ka prerë gojën.

Qëndruam kështu pa folur nja dhjetë minuta. I gjori Peço shfryu tërë pikëllimin në një psherëtimë.

T'ëmën ç'bëj këtu n'Amerikë, unë bre?! Ëh? Dua të siguroj një jetë më të mirë-o? Po ç'duhet bre, kjo jetë, që do të më kujtojë se e lashë mamanë të më vdesë, jo dyke i ndënjur pranë, por dyke pritur vetëm ç'më thonë në telefon!?.. " Ti moj korbë, po vdes?" e pyesin me siguri moshataret e saja, mamanë. "Po vdes", u thotë ajo. " Po ku e ke djalën e vetmë?" - "Ai më ka vdekur më parë, katër vjet të shkuara, kur u nis për Selanik… Që të rronte!… E andej më vdiq!".

Dhe Peçoja qante duke mos u përpjekur fare ta mbyste vajin dhe i fshihte lotët me dorë. Pëllëmbët i ishin bërë qull. Unë i vura thjesht krahun mbi sup dhe mezi përmbahesha vetë. Kur Peçoja mbyste ngashërimin, i linte udhë bisedës imagjinare që bënte e ëma me shoqet e saja plaka.

- "E që atëherë nuk e ke parë më, moj ditëzezë?" " Ja, për ta parë po nisem" …

Peçoja u ngrit me rrëmbim dhe u vërsul në banjë. Pas pak doli duke fshirë fytyrën

me peshqir. Ishte qetësuar disi. Më pa drejt në sy e më tha:

I ndodh bre, kjo, shumë mërgimtarëve. Nuku kanë se ç'të bëjnë, ce nuku këthehen dot më këtu. Pa marrë dokumentet, nuku puthin më dot në Amerikë!.. Vetë e dinë sesi i gëlltisin halle të tilla!.. Ama unë nuk e duroj dot. Nuku duroj! Më zuri pa pritur kjo arë gungë, mor më ia …. Ngreu prefesor, e ikë të lutem. Ikë!

çfarë pate?! - e pyeta i befasuar që desh të më përcillte.

Të tjerët nuku ma dinë hallë, kështu si ma di ti dhe jotë shoqe. Ata dhe do të më flasën edhe do të pinë me mua kafe. Po yve, ty dhe zonjës, unë nuk ju dal dot përpara. Se juve e patë si mua po më vdes nëna e më patë si po rri këtu, në këtë *** vend, ngaqë pastaj nuku këthehem dot më.

E di Peço, nisu! e këshillova unë me vendosmëri. - Do të kujdesem unë për biletën tënde… Kushedi më vonë… Ti po vuan shumë. Ikë, dëgjomë mua!

Ai u plas në krevat.

Nuku mundem. Babaj thotë: "Mos hajde". Motra më kërcënon: "Po erdhe, nuk të flas më me gojë! Bëre gjithë këto sakrifica. Tani merr dokumentet dhe për gruan e fëmijët"… Gruaja… Rezarta, më thotë:

“Bëj si të duash”.

Unë vendosa t’i jepja fund egërsisht, lëkundjes së tij.

Mos i dëgjo ata. Unë të them shko!

Ai filloi të dëneste përsëri dhe gjendja u rëndua mjaft.

As i dëgjoj ata unë or jo! Asnjërin pe tyre! Por… do të dëgjoj mamanë… Ajo, para se të priste gojën, i ka porositur: “ M’i thoni Peços: mamaja do që të mos vish! Ky është amanet im i fundit. Ma shkeltë, do t’ju mallkoj të gjithëve që nga gropa!”,- u ka thënë… Pandaj po më luten të tërë, që të mos u vete…

Shkulmat e dënesave po e mbytnin njeriun e gjorë. Ai nuk më fliste dot, por me dorë më bënte shenjë të largohesha dhe ashtu, nëpër trazim të shpirtit të tij, gjente radhë e më thoshte:

Ikë, të lutem ikë! Dua të rri vetëm.

* * *

Mamaja e Peços vdiq atë natë. E kishin vënë plakën në varrezat e fshatit.

Ime shoqe dhe unë i bëmë një vizitë Peços, pas varrimit. Ai tani ishte krejt i qetë. Furtuna kishte kaluar e pati bërë dëme, por mbi shkatërrimin, kishte hedhur synë një diell i qetë dhe i ngrohtë.

Ai i buzëqeshi gruas sime dhe, duke na servirur nga një gotë ujë me akull, na tregoi se varrimi kishte përfunduar gjysmë ore më parë.

- Kishnë marrë me qira një celular të një fshatari që punonte në Greqi. E mbante nipi im. “ Mos të më flasë njeri në atë celular,- i thashë nipit,- vetëm mbajeni tërë kohën hapur e lemëni të dëgjoj”. Vetëm një shok pe atyre të parkut të mallrave nuku iu bind nipit e porosisë time, po iu afrua celularit e më thirri. “Jam Tirka, Peço, mbaje veten! Që pe Korçe, në këtë mes dimri, të kemi ardhur pesë shokë!” Ay desh të fliste akoma, po nipi e largovi… Në odën e burrave më bëhej se ndjenja erën e duhanit. Pasaj, dëgjonja gratë që qanin. Një e dy përmendej emri im,… që ime-më, e zeza, nuk më pati pranë… Celulari kishte cilësi të mirë. Motrës sime i ra të fikët. Dëgjonja që thërrisnin për ujë. “Ujë, ujë!”- ulërinin tëra gratë njëherësh, me alarmë. Dëgjova kur nxuarrë mamanë dhe e nisnë në varrezë të fshatit. Dëgjoheshin këshillat e burrave: “Veri dorën këtu, ju të dy ngrijeni arkivolë nga ajo anë!”. Pasaj me sytë e mendjes shëkonja tërë rrugën e fshatit, ce dëgjonja dëborën e pashkelur, që kërciste dënë çapet e njerëzve që e mbajtnë mamanë time mbi supe, gjer te varri. Edhe kërcitja e dëborës dëgjoheshe, kur mos kem….

Këtu Peçoja u kujtua. Dhe qeshi hidhur:

Tani nuku do betohem më “kur mos kem mamanë!” tha me një buzëgaz të hidhur. “Tani unë atë… nuk e kam më!”

Në dhomë ra heshtja. Peçoja bëri edhe një përpjekje të shfaqej si më parë, i gjallë e me humor.

Nuk e kam më… Dhe unë… Oho, ku ka si unë bre! Unë jam n’Amerikë ore!

Vetironia e tij nuk kishte asnjë dritë nga ai gazi që Peçon s’e linte kurrë. Peçoja dështoi në përpjekjen e tij. Dhe zuri përsëri të qajë….

Rrefenja e trete - Një nuse shqiptare rrëmbehet në Nju Jork

Tëmën bre!, duhej pa tjetër të vinja gjer në Amerikë që të mësonja se sa ndryshojnë zakonet nga të katër anët e vendit tonë të vockël. Po çudia më e madhe është se ca krahina jo vetëm që i ruajnë duke ua treguar nipkave të lindur në Amerikë se ç'lloj zakonesh ndiqnin një herë e një kohë, po edhe i ndjekin këto zakone akoma. I venë në jetë si në fshat edhe këtu, në mes të Menhettenit! Paçka se në vend të oborrit të fshatit, tani kanë tri metro trotuar, në vend të qenit, kanë një alarm e në vend të kalit venë e marrën nusen me limuzinë!

Ca ditë të shkuara, një të diel, e kishnja parkuar limuzinën, - demek, kalën e nuses, - para një billdingu. Në një nga apartamentet, në kat të tetëmbëdhjetë, ca gra këndonin këngë popullore për çupën që po e nxirrnin nuse pe shtëpisë së babajt. Rrugica ishte e ngushtë, siç janë të ngushta e të kufizuara tërë rrugicat e Menhettenit, që kanë veç një drejtim kalimi.

Një makinë policie kaloi bri meje dhe oficeri pa me një farë dyshimi se si kishnja parkuar, po nuku tha gjë. Para 40 e ca vjetësh në fshat, ma ha mendja, parkime nuku kish dhe asnjëri nuku ta shihte kalën me dyshim.

Në këto mendime më thanë të ngjitsha lart, ce më kërkonin. Vajçë pas atij që kish erdhur të më merrte.

Ishte një goxha ndërtesë me roje me uniformë. Një njeri tjatër, po me uniformë, na shoqërovi deri te ashensori dhe hyri tok me ne gjer në kat të tetëmbedhjetë, ku na la të dalëm për të vajtur në apartamentin ku qe nusja, ku ish rritur që foshnjë e gjer sa pat mbaruar universitetet radhë. Hajde apartament, hajde! Lluks o lluks, të të ikte mendja, kur të qaj babanë! Ishte familje e kamur, e ardhur n'Amerikë që para tridhjetë e kusur vjetësh, që kur Titua pat hequr gardhet e kufinjve. Më pritnë me shumë respekt, megjithë rrëmujën që sillnin tërë ata njerëz të ndodhur aty e me tërë zhurmën që bëhej. Në një qoshe të korridorit ndodhej një pjano e madhe, kurse dëpër mure kish piktura, vënë në ca korniza të rënda, ngjyrë floriri. Para se të hynim në atë sallon ku rrinin burrat, nusja na kalovi përpara. çupë, po çupë ore! T'i rrëmbenje kokën bre, e të iknje me vrap. T'i thoshe të Madhit Zot: e po mja'o Zot! Mjaft, veru kyçnë martesave tashi, ce nuse si kjo, në donjë planet tjatër ndofta, por mbi këtë rruzull, nuku vjen më! E gjatë, si selvi e stolisur. Vinte, sidozot, një pëllëmbë mbi mua: me një celular që e shtërngonte mes supit dhe veshit e me një hartë në dorë, i shpjegonte donjë shoqes së saj, se ku ishnë drejtimet e hotelit, ku do shtrohej darka. Ajo më pa mua, kapellën time pe limuzinisti, më

njohu se kush ishnja dhe kërkovi ndjesë në telefon. Më dha dorën e më tha:

Unë jam nusja! Tash ti je pjesë e kujtimeve në këtë ditë të lumtun për mue!

Të trashëgohesh! E mbushç shtëpinë me djem! - ia bëra.

Nga dhoma e grave krisi kënga që thosh pak a shumë , - se tani s'i mbaj mend fjalë për fjalë e rimë për rimë, që thosh: - "kali që po të merr tynë, të sjelltë të shohç babanë, kali që po të merr tynë, të sjelltë të shohç mamanë, kali që të merr tynë, të sjelltë të shohç gjyshnë… "

Nga lista e këngës mora vesh, se i zoti i shtëpisë, veç nuses, kish edhe gjashtë fëmijë të tjerë, për të cilët duhej të vinte kali, që në këtë rast, ishte limuzina dhe unë përfaqësuesi i saj. Qënkej dashur të ngjitsha lart unë, që gratë të merrnin këngën e kalit.

Më qirasnë me ëmbëlsirë, darovita dhe u derdha tatëpjetë kateve, se do nxirrnin nusen..

Njerëzit filluan të zbrisnin. Në sallon poshtë. dëgjoshin gratë që kishnë zbritur dyke kënduarë, po para se të shfaqshin ato, dolli dhëndri i qeshur, i qeshur sa të thoshe ti, se nuku nevojitej më djellë në Menhetten! Ay u fut në limuzinët dhe u afrua afër dritares të shëkonte. Duallë gratë që këndonin. Të tëra i kishnë sytë me lot dhe, - si duket nga mallëngjimi, - nuk e vazhdonin dot më këngën e kalit, që do ta kthente nusen të shihte të vetët, dyke filluar nga gjyshi. Si nuku e shpunë dot këngën gjer në fund, gratë nisnë të fshinin lotët, por mendjen e kishnë nga porta, pe ku do dilte nusja.

Vetura e policisë po vinte gjene prapa meje.

Tëmën!, - thashë me vete, - këta hajvanët duan të ma kripin, të më zenë më

donjë faj!

Por oficerat vetëm një vështrim hodhnë nga unë, se u bënë më shumë kurreshtarë me dasmën. Ec, e shëko prapa ata.

Po dilte nusja. Unë nuku kishnja parë donjë zakon të tillë. Theatro o theatro, kur të qaj tërë! Ishin dy vëllezër të dhëndrit, që duallë nga dera me kurriz e seç tërhiqnin me zor, të thoshe ti donjë sëndyq, a baulle të rëndë. Tëmën, ç'tërheqën këta-o?! Kur shoh unë: nusen! Tërheqkëshin nusen, ore! Këtë radhë ajo nusja e lumtur e katit të tetëmbëdhjetë, qante, përpëlitej e u kundërshtonte atyre që donin ta merrnin gati zvarrë. Demek, ajo nuku donte të dilte nga dera e babajt, por nuku kish ç'të bënte, ce po e rrëmbenin! Ata ishnë djem të fuqishmë dhe e tërhiqnin pa pikë mëshire. Tashi edhe ajo xhanëm, bënte sëkur u kundërshtonte, por ama, për të qarë qante vërtet!

Dhëndri prapa meje qe rehatuar në limuzinë dhe vështronte me buzët vesh më vesh, në gaz! Ce të mos qeshte ay!..

Te dera, prapa nuses, duallë dhe prindët. Babaj e mbante veten, por nënës i vinin lotët lumë. Qanin gjyshi me gjyshen, qanin motrat e vëllezërit, por asnjë nuk e ndihmonte çupën. Veç njëri nga vëllezërit e veckël, u hodh në ndihmë të motrës që luftonte me ata që po e rrëmbenin. Por nusja la të qarët, i këputi të vëllajt një pëllëmbë dhe ay shkovi i bindur të qante në grupin e familjarëve të tjerë, që ishnë të prekur jo pe atij rrëmbimi theatror, por ngaqë çupa njëherë e përgjithmonë po u ikte vërtet pe rrethit të ngrohtë familjar. Njësoj-o siç qajmë të tërë, kur nxjerrëm për herë të fundit nga shtëpia, çupat, motrat, kushërirat.

Përleshja u bë më e fortë, kur njerëzit e dhëndrit deshnë ta hipnin nusen në limuzinë, nga dera që unë paçë lënë hapur. Aty nusja m'u duk se nuk desh të hipte vërtet. Të qarat u shtuanë edhe më.

Në atë çast, - ja kur mos kem babanë në gënjej, - u dëgjuanë dy të shtëna kobureje dhe të tërë ngrimë. Ngriu nusja, ngrinë ata që po e tërhiqnin pe krahësh. Aty para hundëve të limuzinës, shohëm dy polica që po vrapojnë drejt nesh. Në duar kanë koburet, që akoma nxjerrën tym pe grykave. Ne nuk e kishmë vënë re fare që makina e policisë që pat kaluar aty përpara, pat qëndruar ca metro më tej. Kush e kish mëndjen te policat! Ata patnë soditur daljen e nuses dhe kur panë që ajo përpëlitej në krahët e dy meshkujve, çapëlyenë sytë e dhanë alarmën: "Friizë! Friiiizë!"

Pushuanë të qarat. Policat u drejtuan revolet atyre që po rrëmbenin nusen dhe u thanë të mos lëvizin. Vëllezërit e dhëndrit, dyke qeshur, i ngritnë duart lart. Qeshnin ata, po nuk qeshnin hiç policat! Njëri polic ruante me grykën e kobures, tjetri i urdhërovi djemtë të mbështetshin me të dy duart mbi limuzinë dhe i kontrollovi për armë, pa u vënë veshin shpegimeve që u vinin nga dasmorët që i rrethonin nga të katër anët.

Rrëmbim personi, - thanë dy policët. I organizuar!

Njëri nga ata mbeti me kobure ngrehur të mbante dasmorët, kurse tjetri i hoqi mënjanë dy njerëzit e dhëndrit dhe nusen.

Ti, - më tha mua polici që ruante, - merr dokumentet dhe shko me të tjerët. _

Asnjeri tjatër mos afrohet! u ulërinte krushqisë. Apo nuk oshëtijnë rrugët e Menhettenit!

Dasmorët zbardhnin dhëmbët. Asnjëri nga të nuses nuk qante më. "Hej o bela", - thashë unë me vete, - "edhe kjo na duhej tani. Do ta

kaloj në burg natën sonte!”

Mora dokumentet dhe u bashkova edhe unë me grupnë. Po ta quanin vërtet rrëmbim e po të mos bindshin policat, unë duhet ta hanja mirë se kishnja mjetin, mjetnë e rrëmbimit!. Gjobë po e po, por tashi si vajtnë punët, gjobën ta puthnja!

Nusja dyke qeshur me një kërkëllimë të butë, po shpegonte tërë historinë. Ajo u foli për zakonin e dikurshmë të fshatit të tyre, u tha se ajo po e zbatonte edhe këtu nën grataçielat e Menhettenit, për t’u bërë qefnë gjyshërve pleq dhe shpresonte se dasma nuku do kish tronditur rendin publik. Policët, një i zi e një i bardhë, e shëkonin me mosbesim. I pyetnë dhe ata dy të tjerët dhe ata thanë po të njëjtën gjë. Më panë mua dokumentet, u tregova që punonja për një firmë të njohur limuzinash dhe u thashë që unë aty nuk hynja hiç, se unë isha thjesht i paguarë.

Tërë shoferët që angazhohen për rrëmbime, paguhen, - tha polici i zi.

Në atë kohë dyke u rënë sirenave, erdhën dhe tri makina të tjera të policisë, me

një vargan me polica, që sakaq duallë nga veturat dhe u bashkuanë me ne. Zallamahi e madhe, ore. U zu trafiku e mizëri e kalimtarëve na rrethoi anembanë. Policat llafosshin me njëri tjetrin vështronin nga dasmorët dhe dalëngadalë po bindshin.

Je më shumë se tetëmbëdhjetë vjeçe? e pyeti nusen njëri pe tyre, sa për

formë, se tani ishnë sqaruarë të tëra.

Ohu! tha nusja. - Faleminderit që dyshoni për këtë! Unë jam avokate

dhe… dhe bile punoj në një agjenci për të drejtat e njeriut!

Policat u shkrehnë fare. Njëri foli me qendrën në radio dhe ua tregovi meselenë me buzë në gaz.

Vazhdoni! - tha duke mbyllur radion. Shumë interesant. Paçi jetë të lumtur!

Mua më dhanë dokumentet e unë psherëtiva i çliruarë. Nusja ua zgjati gjene

duart të dy krushqëve që aty më parë po e “rrëmbenin” dhe ata nisën ta tërheqin me zorr që nga mesi i policave. Vajza zu të shtirej prapë sikur kundërshtonte, sikur u kërkonte ndihmë popullit të Nju Jorkut dhe kur iu afrua limuzinës, ajo u këthye edhe një here, ashtu si demek duke qarë dhe çapkënçe ua shkeli synë policave, që rrinin

duarkryq dhe dyke parë çupën shqiptare, dukshin sikur u lëshonte goja lëng.

Kot paska qënë martesa jonë, - thoshin me vete policat më të vjetër.

E ç'shpresa mbetnë më për ne, - dukej sëkur thoshin policat beqarë.

E nuku flisnin asnjë llaf, por mendonin me vete se me çupa të tilla të bukura,

fshatrave të Shqipërisë, domosdo do t'u shkrepte dërmend një zakon si ky i rrëmbimit.

Ajo, nusja që po dilte sot nga Menhetteni, ia vlente të bënje marrëzinë e ta

rrëmbenje!… Kur mos kem babanë, edhe gjyqet e Amerikës të nxirrnin me siguri të pafajshmë!…

Rrëfenja e katërt: Një politikan i Tiranës vjen në Uashington

Nuk heq, që nuk heq dorë Nesti nga politika!..

Nesti këtu në Nju Jork dhe im kunat atje në Tiranë, secili nga një djalë të vetëm kanë, po veç, kur bëjnë be për kokë të kryetarit të partisë, besoju, s'të gënjejnë!

"Shëko bre kushëri punën këtu n'Amerikë, se e ke të mirë,- i them ngaherë Nestit,- e mos shëko ç'bëjnë ata që kacafyten në Shqipëri, oreee!" "Qepe, Peço, se ti nuk di nga lidhet gomari, ma këthen ay. E mira jonë është në mëmëdhe!"

Tëmën e sëmës, që nga Amerika, Nesti paguan kuotat e partisë në Shqipëri! Seç e kanë vënë atje në një këshill të përgjithshmë, vete jep intervista, del në televizor e u thotë broçkulla sikur demek, Amerika i ka sytë te parti e tyre!

Më vjen Nesti një natë, kur po parkonja limuzinën e më pyet a do isha i zënë javën që vinte. E pyeta ç'kërkonte e më tha se të mërkurë, më desh me limuzinë në Vashington.

I madhi i partisë tonë vjen nga Tirana e do që të takojë të mëdhenjtë e

këtushmë, - tha. - Ti do vish me mua e do të të mbaj atje. Ta kesh për nder, se limuzina tënde do të vejë dëpër tërë takimet. Të pëlqen?"

Më pëlqejnë paratë, - i thashë. - Unë punë dua!

Ay më tregovi për zgjedhjet që do bëshin në Shqipëri ato ditë e më tha se për këtë

Nesti do të shkonte që nga Amerika e do rrinte dy javë në Tiranë. Do ikte tok me të madhë e partisë, pe Vashingtonit, në një aropllan. Unë do i shpinja gjer në aroport e pastaj do këthesha vetë në Nju Jork, të premten mbrëma.

E prishur mos qoftë! - i thashë.

Nesti më porositi ta qepnja gojën për sa do shihnja e sa do dëgjonja. Zgjedhjet

në Shqipëri ishin të fituara dhe ardhja në Vashington do t'u vinte vulën.

Paratë nuk do të t'i kursejmë, - tha Nesti, - po këto dy gjëra i duam nga tynë:

limuzinë të ndritur dhe gojë të qepur!

S'të flas dot , - ia bëra se e kam qepur që qëparë!

Ma shtërngovi dorën sa më krisnë koskat e me Nestin u pamë të mërkurë.

Nga Tirana të nesmen më mori kunati pa gdhirë në telefon e dukej se po

fluturonte: - Ay…, dëgjon-o? Ay, i madhi jonë, vjen atje! më tha, - po nuku flas dot gjatë se s'kam para! Dhe krëk ma mbylli.

Si Nesti dhe kunati im paskej plot këtu te ne, se Kryetarë e partisë, atë të mërkurë mbrëma, n'aroport të Vashingtonit, kishnë dalë ta prisnin nja njëqind veta. Nesti më tha që ta hiqnja limuzinën mënjanë se ai, pas takimit me mërgimtarët, do ta nxirrkej Shefnë nga një derickë e fshehtë. Ashtu u bë. I mbajta hapur derën Shefit, ay hipi me nxitim në limuzinë, tok me një badigard, dy ndihmësat që kish me vete, pas tyre Nesti dhe çamë ferrën dëpër natë. Nesti më jepte drejtimnë e ata flisnin për zgjedhjet e për ca spiunë të partisë që paskërkshin nxjerrë sekretnë e udhëtimit të Shefit n'Amerikë. Nga llafet e tyre mësonja se dhe njerëzit që e njatjetuan në aroport, nuk patnë arritur të marrën vesh as hotelë as vendet e takimeve me politikanët amerikanë. Desh Zoti, sekreti nuk ka dalë i tëri, psherëtivi Shefi.

I shpura buzë lumit Potomak, në një hotel të zinxhirit Hollidei Inn. Potomaku, vënde vënde, më kujton Devollë, kur e frynin shirat e vjeshtës. Zumë dhomat: ca oda pa salltanete në kat të katërt. Mysafirët pe Tirane iu sulë krevatve e ranë si të vdekur. Mua më patnë caktuar në një odë me badigardë, që as më foli as i fola, se dhe ay ra top në krevat.

Të nesmen u ngrita shpejt e bëra gati limuzinën. E fërkova e bëra xixë dhe nisa të prisnja rrugën e parë, po asnjeri s'po bëshe i gjallë. Aty afër drekës njëri pe ndihmësave dolli nga hoteli, u këthye sakaq duarmbushur me gazetat më kryesore amerikane dhe u ngjit me to, në odë të Shefit. Ndihmësin e pashë prapë në ballkon, që më thirri lart se Shefi desh të më takonte. Lashë fërkimnë e limuzinës e bëra përpjetë shkallëve. Kryemysafiri më dha dorën e më falnderovi. Atij i qe bërë qefi shumë, që isha kusho me Nestin. Kushua, aty mënjanë, qeshte si maçok. Ndihmësi tjetër në odët ngjitur, po provonte të lidhej me Librazhdin. Me ç'dukej ai nuk kish gjetur cilësi të mirë linje, se të thirrurat po shponin muret.

Alo Librazhdi këtu Vashingtoni? Më lidh me Ruzhdinë. Këtu Vashingtoni

jemi… Librazhdi? Ruzhdi? Hë… E prezantuat kandidatnë-o?

Ca më tej ay solli te Kryetari lajmet e Librazhdit dhe tregovi se tërë gazetat e

vendit vrisnin mëndjen për këtë udhëtim n'Amerikë. Ay tha se për këtë udhë, entuziazmi në besnikët e partisë, kish arritur qiellë e ish ngjtur më la. Në sytë e mëndjes, mua m'u fanit kunati.

U kërkova të më jepnin lejë të dilnja e t'i prisnja te limuzina, por Shefi më tha se do hamim bukë tok, aty brenda në dhomë të tij. Badigardi solli dy pica të mëdha sa dy lëmenj dhe u mblodhmë të tërë rreth tryezës. Ashtu siç përtypçim, pica u kujtovi atyre Italinë dhe atëças u përshesh muhabeti: u zu në gojë një farë Ruteli, komisjoni i zgjedhjeve në Kurbnesh, një fjalim që paskërke mbajtur një me emër Beluskoni, lista shumëemrore që duhej rishëkuarë, blerja e një mikrobusi Fiat për partinë, prapë pica dhe prapë nevoja e kontakteve më të shumta me Italinë.

Pas dreke e fshiva edhe dy herë të tjera limuzinën po nuk vajtmë asgjëkundi. Dhe ata prapë u shtrinë shpejt. Tëmën, thashë, kaq të lodhur të jenë këta-o?!

Do kishim ditë të ngarkuarë të nesmen e unë që pa gdhirë i futa një të hekurosur kostumit. Ama, krëckë e kisha! E vishnja për herë të parë. Sebepi ish i madh bre. Nuk do të dilnja si rozgë, kur t'i hapnja derën Kryetarit n'oborr të Departmentit të Shtetit, a dofta … në Shtëpi të Bardhë! Ama, më kujtohej Shtëpi e Bardhë - shurra më zinte! Ajrosa limuzinën i shfryva ca livando nga shishka më e mirë dhe i kuptosa dyert. Pastaj nisa ta fërkonja maqinën prapë. Fërko e fërko… Po më bëshin gishtrinjtë copë, e ata s'bëshin të gjallë!

Nga ora njëmbëdhjetë Kryetari dolli në ballkon të tij. Më pa te limuzina, e ma bëri njatjeta me dorë. Pastaj u ul në një karrekllë e piu atje një kafe e dy Marllboro. U këthye prapë brenda, po nuk harrovi të më thërriste lart. Vajçë. Në korridor ngatërroshin të thirrurat e ndihmësave, që që nga dhomat e tyre, lidhçin me zonat e zgjedhjeve në mëmëdhe:

Këtu Vashingtoni! O ti Fieri, a i ndreqtë listat e votuesve të Sheqit

të Madh? Nga Vashingtoni pyesim…. Alo! Paskuqani…

Bëhej një lëmazhdë emrash e fshatrash shqiptarë, që flisnin me Vashingtonë,

aq sa të hipte dëpër trup një zjarrllëk respekti a krenarie për këta djem të palodhur, që këtu dy çape pe Shtëpisë së Bardhë, mëndjen e kishnë atje te zgjedhjet, te kutitë… Nuk dinin pushim, ata oreee, por varda, sa mbaronin me Bilishtnë kërkonin Hotolishtnë, sa linin Paskuqanë, lidhçin me Murriqanë! Kur mos i kem tërë, bota qe bërë e vockël!..

Ndihmësat i suallë Shefit një vandak fletësh me artikujt pe të

gazetave shqiptare, që vizitën e tij të papritur në Vashington njëra palë e shëkonte si ogur të mirë, kurse pala tjetër e shëkonte me shqetësim, me parashikim të donjë lëvizje të papritur të politikës së jashme të Bushit. Hamendje gjithfarë-o!. “Obo-bo ç’do më hapet punë mua” thashë me vete dhe xheç zbrita prapë të fërkonja limuzinën, po Shefi më tha të rrinja se do hamim prapë drekë.

Sufllaqkat që kish blerë bodigardi ishin të nxehta. Sufllaqet shiteshin shumë n’Amerikë e ky sebep u solli atyre në sofër punët me grekërit. Ashtu dyke ngrënë i qëndisnë një telegram Simitisit, për ditën e lindjes.

Kur kish akoma dhe donjë hosten diellë, ngjavi ajo që prisnja që pe dy ditësh: erdhi sëra e limuzinës time! Nesti dolli në ballkon e më thirri: - Tani, Peço, ndize e rri gati!

Sa të vinin ata unë u pashë në pasqyrkë: kostumi ishte akoma krëckë, një rrudhkë s’i kisha bërë! Ata xbritnë me valixhe dëpër duar e u futnë vargan në limuzinë. Pashë nga Nesti, demek, më jep udhë!

Në aroport! Jemi për Tiranë! - ma bëri kushua. Unë e pashë me çudi, po ay

më shkeli buzën e poshtme, demek, mo ha ***, po bëj ç’të thonë, ti një copë shofer je dhe paratë t’i dhamë!

Ama jo, thashë me vete, ç’punë kam unë se erdhka një delegacion nga Tirana për një picë e dy sufllaqka!

E u bëra erë…

* * *

Kunati më mori në telefon nga Tirana, që të nesmen. Avazë, ay:

Peço unë po e mbyll e më merr tinë, që andej, ce unë s’kam para!

Nuk e zgjata. Kunati andej, nuk mbahej nga gëzimi. Më llafosi plot

tetëmbëdhjetë dollarë e njëzetetre cente. Kaq dëftente fatura e telefonit , kur më erdh më prapa . Më tregovi që ishte tok me qindra e qindra të tjerë, që kishin pritur kryetarë, në Rinas.

E di ç’u bë këtu-o? Zjarr, bre zjarr! Xheç u dogj Rinasi, o për kokë të

Benit! Më llafosi Nesti për ty. Po ti, o zuzar, ce nuku na the që kishe qënë me limuzinkën tënde në tëra takimet? Mirë thonë, që Peçua në vend të gojës ka kasafortë!

Të mos kisha vënë dorën mbi kasafortë, unë xheç ia plasa të qeshurit.

Dëgjon-o?. E di bre, si ishte Rinasi? Kur u dha Shefi te dera e

oropllanit me

atë fytyrën e tij të bukur, që i llapste nga drit e gëzimit, nuk mbahej populli. Policia po hiqte të zinë e ullirit. Gazetarët ishnë çkulur dyke lënë tërë aktivitetet për zgjedhjet e ishin ngulur atje pe dy orësh. Unë isha afër me kandidatnë që vumë në Librazh. E zumë kryetarë dhe e hodhmë përpjetë. Gazetarët xheç e mbytnë me të pyetura: “Si shkuan takimet në Vashington? çfarë premtime muartë pe Shtëpisë së Bardhë? A është e vërtetë që takuatë Povellin? çfarë u tha Povelli?”… Kryetarit i rrëzëllinte çehrja. Ku e gjen gjithatë nur o në p.. të sëmës! E di ç’u tha-o? “Zotërinj, - u tha, - kot ini munduarë. Rruga jonë ishte një shëtitje e thjeshtë, për të bërë pak pushim buzë lumit të Vashingtonit” Me një llaf, kush ka mënt le ta kuptojë! Aty u dha një nga ata gazetarët turi-misqinë, që Kryetarë tonë e do ta shohë të pjekur në hell. E pyeti: “Zoti Kryetar, ka pështpëritje që ky udhëtimi juaj i papritur, ish urdhëruar nga Bushi… Me cilin biseduat ditën e parë?” E di si iu përgjegj Kryetari-o? më pyeti kunati nga Tirana.

Jo, - i a bëra unë që këtej nga Nju Jorku.

I a dhjeu inglisht: “ Uell!… No-mor-komente”, i tha… E di ç’do të thotë kjo,

o Peço?

Jo, - ia bëra unë prapë.

Kjo do të thotë: tashi do ia shëkoni avazë kësaj rrugës që bëmë ne atje! Tashi

që vamë në Vashington-o? Tashi, hapuni maskarenj, se do t’ju hamë tëmat!…

Rrëfenja e pestë: Takim me dy gogolat e parë sa shkel në Amerikë

Na iku jeta duke pritur! Herë presim një gjë e herë një tjetër… Një herë prisnja ditën e gjyqit… Më vonë prisnja fundin e burgut, pastaj vizën për Greqi, pastaj Amerikën, kartat më vonë… Mos pyet!…

Papo të më zbresin një ditë të bukur, me dokumente të rregullta në aeroportin "Kenedi", e tërë familja ime!… Mall-çmall!… Mall-çmall!.. Kështu na kalovi jeta neve shqiptarëve, or q..fja tëmën! Po të mos paskëshin erdhur në këtë botë shqiptarët, as fjala mall nuku do vinte, nuku do duhej! Nuku do kish patur nevojë për atë fjalë, ja, kur mos i kem tërë!

Ecnim të pesë, në mes të dritave, shuk në taksinë time. Punoja me taksi ato ditë. Nuku flisnim. Shëkonja binjaçkat e hutuara, Dritën, Lirinë.. Djali, Fatlumi, -që sa i shkathtë është, - dukej si i humbur. Kurse Rezarta, gruaja, nuku kish asnjërën as tjetrën: atë po e llahtariste Amerika që ditën e parë!… Dhe nuk iu hoq llahtara për kushedi sa kohë…

Ata që nga nevoja vendosen në Amerikë, llahtarisen nga dy gogolat që kumbisin të parët në udhë të mysafirëve: gjuha dhe çmimet. Meqë të sapoerdhurit nuk ujdisen kollaj me punë, paratë që sjellën, i kanë me krëk. Oh sa dhembin të shkretat, se ata, o kushedi ç'kanë shitur, o kushedi nga ç' borxh i kanë! E borxhi ta bën tërë gjemba jataknë. Të sapoerdhurve u duhet kohë që të shërohen pe sëmundjes të përkthimit në lekë, të dollarëve që shpenzojnë. Dhe në llogari përdorën të vjetrat, dyke shpresuar që kështu do shtyhen më shumë që ta mbledhën dorën.

Ja, një çyrek bukë, këtu nuk e ble dot pa tre dollarë, gjë që në mendje të sapoerdhurit përkëthehet afro 4500 lekë!

Epo kurrë mos u ngrëntë një bukë që të bën t'u nëmërosh kafshoret

fëmijëve! E për këtë të vret Zoti!- ulërinte ime shoqe ditët e para sa shkeli në Amerikë. -Binjaçkat vanë e blenë nga një akullore dymijë lekëshe, - katër mijë! Ky bandilli, Fatlumi, e ka marrë akulloren e tij tremijë e pesëqindëshe..Se ky, hm, na bën vezë të kuqe, ky! Shtatëmijë e pesëqind lekë akullore, fëmijët e tu e temit, i përpinë në dy minuta! Një herë e një kohë, shtatëmijë e pesëqind, ti Peço, mezi kishnje rrogën e muajit!

Rrah ta qetësoj se sapo ka ardhur dhe, e gjora, duhet të përmblidhet:

Rezi, moj gruaja ime e ëmbël,.. sot,… unë,.. nga puna me ca turistë

arabë, të

kam sjellë 18000 lekë, rrogën e ditës dhe 10 000 bakshishet! I thonë 28000 lekë që Enver Hoxha s'i merrte në muajt! i them unë, dyke ia këthyer dollarët në lekë, që ta gëzojnë nusen më shumë e dyke ia bërë Enverë, si më të dëmtuarin nga gara me familjen tonë,. Po Rezi nuku dallon pe tërë të erdhurve të tjerë në Amerikë, të cilëve u duket e natyrshme të paguhen shumë, por jo të paguajnë shumë…

çupkat tona binjake më kërkuan para, t'i blinin mamasë një shall, si dhuratë për ditëlindjen. Mamasë i ra të fiktë e xheç u bë për të, ditë lindje e vdekje tok, kur mori vesh se shalli pat kushtuarë 42000 lekë!

- Me 42000 lekë aty përpara blinje një shtëpi me dy kate e strehonje familjen. Tani me aq, unë mbështjell vetëm qafën! Pa hajde Drita, - i thotë njërës pe binjakeve. - Më hap kumpjuterin e më shëko aty, me sa këthehet dollari sot në Shqipëri?

E Drita i bindet tak fak: - Një mijë e katërqind e njëzet!

Uau!.. Këthehemi, Peço! Këtu nuku rrojmë dot. Një miljon e shkuarë

miljonit paguajmë në muaj për shtëpinë! Unë punë nuku po gjej. Fëmijët duhen veshur!

Bëj t'i shpegoj se llogaritë këtu bëhen ndryshe, ajo më thotë se asaj i paskëshin

thënë, që edhe në Amerikë dy e dy bëjnë katër!

Fëmijët përdorën për shkollë karta udhëtimi, që u jep administrata. Me to ata mund të bëjnë dy vajtje e ardhje me atobus ose tren ndënë tokë. Rezi për vete, shkon deri afër shkollës për të blerë zarzavate e vete e vjen më këmbë, pasi nuku do që t'i hedhë kot pesëmijë lekët.

Një ditë Fatlumi ynë, pat lojtur fotboll me shokët e shkollës e ish lodhur shumë. Blevi domatet që e pat porositur e ëma dhe pa se kish humbur kartën shkollore, që paraqitet në atobus. Pagovi nga kusuri i domateve një dollarë e gjysmë të këthehej në shtëpi.

E ëma kish rrëmbyerë okllahinë, që bën petët e unë e gjeta dyke dumballisur të birë.

Humb kartën dhe më prish, pa i a bërë tërr syri, dymijë e dyqind e pesë lekë!

Unë, e ëma, me kryqe të këputura, vij që andej më këmbë!

Për t'i marrë okllahinë nga dora, desh ia shkula megjithë krah. I thashë nuses sime të mirë, se këtu prindërit që rrahën fëmijët, hanë dy vjet burg.

Më thuaj, sa burg hanë kur i vrasën! Atë më thuaj!.. Ta dij, para se t'i marr

shpirtin! çirrej Rezi.

Tëmën e sëmës, nuku i dilte e keqja! Mezi e qetësuam. Ra heshtja në shtëpi:

djali nisi të studionte, binjaket po bënin detyrat pranë kompjuterit… Thamë, shpëtuam! Kur ime shoqe dolli pe dhomës së kompjuterit, si pelë që turfullon dhe u sul të kërkonte okllahinë të rrihte gjene prapë të birë.

Tani do ta rrah, se çdo ta rrah! çupat panë kursin e dollarit: në Shqipëri qënka

rritur. Qëparë e rraha për 1470. Tani do ta rrah për kursin e ri: 1520!..

Po, tëmën e sëmës, sa autoritare duket Rezi, në shtëpi, aq e drojtur dhe e trembur është me këdo që i flet anglisht! Dhe pastaj ka sy e faqe e kërkon punë në mes të Amerikës!

Ama, veç syve e faqeve, Rezarta ime ka dhe guxim e paturpësi ore!.. Pa ditur ku bie anglishtja, me ndihmën e një mikes së saj Rozës, e zuri një punë dhe në fund të javës na i futi treqind dollarët në xheeep!.. Ia paguan një familje me origjinë irlandezësh, që i la Rezit në dorë dy kolopuçër, - njëri tre dhe tjetri katër vjeç, - që ajo t'i mbajë, t'i nxjerrë të lozën e t'i ushqejë. Dhe e bën Rezi këtë punë për bukuri. Por vuan kur vogëlushët qajnë, ngaqë shumë herë nuku e merr vesh cili është shkaku.

- E vetmja gjë që mora vesh, është që pushuan së qari! Po as përse qanë, as përse pushuan! tregon Rezarta.

Po mos ish mamaja e djemkave, i ati i tyre nuku do ta kish pranuar kurrë Rezin. Ay dha pëlqimnë për time shoqe, me kusht që brenda dy muajve të shohë përparimnë e Rezartës me gjuhën. Po ay, irlandezi, ia ka vënë të afërt afatnë, bre. T'ia kish vënë dy vjet e jalla të shihte përparim!..

E bukur është, të fshihesh prapa luleve, kur Rezi i nxjerr vogëlushët në ndonjë park lodrash. Do ta shohç që ajo, e gjora, i ndjek me merak, mes kolovajzeve e mes shkallëve me dredhka. E kur në tërë atë zallamahi të fëmijve të shumtë amerikanë, hajd'or hajdë, të dëgjosh zënë e Rezartës se si u thërret atyre që i kanë lënë në hise:

Mos, Kevin, mos! Mos, Xhozef, mos!

Ushëton parku, ore! I xbret kocominjtë, pe shkallëve të larta e i heq mënjanë.

Po mos o Xhozi, baaa! Po mos o bir, të thonë. Them mos: e mos! Merrni vesh

shqip, apo…!

E tërë dita e sime shoqe me djemkat, në rrugë, në parqe e në shtëpi është e mbushur me “mos u lag”, “mos bërtit”, “mos kruaj hundën”. Mos-i është për Rezin vegla kryesore e punës dhe ajo e përdor atë dyqind gjer më treqind herë në ditë. Dhe ata kuptojnë. Ama, kur ajo pas dite i ve vogëlushët të flenë dhe nis e u rrëfen ca përralla që fillojnë “na ishte mos na ishte, në një kasolle të ngushtë me kashtë”, ata nuku marrin vesh asgjë. Fjalët e shqipes jo, po zërin e Rezit tim, që është muzikë e shkuarë muzikës, ata e kuptojnë. Ajo u përkëdhel leshkat me gishtrinjtë e saj, aq ëmbël, sa nuku dihet a u a ka përkëdhelur ashtu e ëma e tyre donjëherë. Dhe përkëdhelkat ata i kuptojnë. E vogëlushët mbyllën sytë e humbasën në kolovajzen me naishtemosnaishte e me kasolletëngushtamekashtë…

Me t’u afruarë dy muajt, që i zoti i shtëpisë i kish vënë Rezit kusht që të

përparonte, ne filluamë të çalltisnim për donjë punë tjatër. Babai i fëmijëve

pothuajse nuk i fliste fare me gojë Rezit, përveç “ditës së mire”, në të dalë e “mirditës”, në të hyrë.

Dje u zunë gjene për punë time, ata, burrë e grua., - na tregonte Rezi një

mbrëmje. - Flisnin për mua me zë të lartë, po nuk i mirrnja vesh, të shkretën! Do më pushojnë, pa një pa dy! Do të na dalën nga dora ata katër milionë lekë, që marr unë në muajt!

Kur po vendosej fati i zonjës time, që do të jipte provim gjuhe përpara atij të

ngrysurit pe Irlande, ngjavi një gjë që e prishi punën më keq akoma. Babaj i atyre kocominjve, po tereziste një pikturë në mur e u hoq praptazi, që ta shëkonte kornizën a qe apo nuk qe drejt. Për pak, xheç u shkeli lodrat dy djemkave, të cilët ulërinë me një gojë:

Mos, babi, mos!

I ati, siç duket, meqë nuk e kishte dëgjuarë donjëherë fjalën “mos”, e kuptovi që

e kish peshqeshnë pe Shqipërie. Hodhi vështrimnë nga Rezi. Ajo uli sytë. E kështu ajo pranovi, që jo vetëm në këto dy muaj, për vete, nuk e kish vënë anglishten në zjarr, por po u mësonte sheleçkave irlandezë, shqipen!

Ay e thirri Rezin mënjanë dhe siç e kish kuptuarë ajo, i kish thënë që atë ditë të

këthehej më shpejt në shtëpi të saj. I kish thënë, dhe këtë Rezi e kish kuptuar mirë, që të mos vinte të nesmen, për pa i bërë ata telefon. Shkurt e copë, siç pushojnë amerikanët! Të thonë prit të të thërresëm e na lerë telefonë. E po dëgjove fjalën telefon, dije, je i humbur, se s'të thërresën kurrë!

Qëllon ama edhe donjë rast i rrallë, si ky i Rezit! E thirrë prapë! Kur mos kem babanë, e thirrë Rezin gjene! Dhe asnjeri nuk e merr dot me mënd se si kish shpëtuarë. Ja se si:

Kur qe këthyerë zonja e irlandezit dhe nuku kishte gjetur zonjën time, ishte mërzitur e kish bërë prapë llafe me të shoqnë. Jo ta lemë, jo ta marrëm! Jo është e mire, po është e keqe! Burri e kish të prerë kapaknë:

- Do t'i japëm paratë e fundit e do t'i themi të mos na duket më këtu!

Po as burri as gruaja nuk e kishnë ndjerë që fëmijët ishnë prapa tyre e po dëgjonin me frikë zënkën e prindërve. Kur babaj tha që Rezi të mos shkelte më aty e qe këthyerë prapa, kish vënë re Kevin dhe Xhozin, që po e shëkonin me sy si të shqerkave, mbytur në lot. Ay mbeti.

Mos, babi, mos! i ishnë lutur shqip me zë të vojtur, të dy djemkat.

Ay qe vërtitur prapë dhe kish vështruarë nga e shoqja.

Mos, - i qe lutur shqip edhe ajo.

E pe "mos"-it e ka Rezarta këtë punë që ka! Ja, kur mos kem babanë!…

Rrëfenja e gjashtë: Urat që të shpien në Menhetten

Se çfarë ngjet në Nju Jork, tri pika e marrën vesh të parat, pe të cilave njëra nuku mungon kurrë. Nuk e di në e merr vesh Tajmsi dhe Si-eN-eN-i, po jam i sigurtë që Beni, djali pe motre, që kam në Tiranë, e merr pa një pa dy!

Motra thotë se Beni bie të flerë shpejt, që me pulat, se është i sigurtë se ç'ëndërr do shohë atë natë. Në sinemanë e ëndrrave të nipçes tem, shfaqen për natë vetëm filma për Amerikën dhe për Nju Jorknë.

I kanë ikur plot shokë Benit, ca andej e ca këtej, po vetëm me ata të Amerikës mban kontakte. Që atë ditë që i shkrepi në kokë Nju Jorku, të erdh e t'u lik djali e s'i vete dëpër mend asgjë tjatër. Ka dhe zanat të mire, o derri, por nuku do e nuku do, që të shohë për donjë punë! Se thotë: "ja, këto ditë, them mos marr vizën". Tetë herë ka hyrë gjer më sot në ambasadën amerikane, po vizën nuku ia kanë dhënë. Tashi Benin e njohën edhe policat që rrinë tek kangjellat. Edhe ata dinë se çfarë përgjigje t'i japën djalit.

Ka dashuri e dashuri, po dashuri si të Benit tone, për Amerikën dhe Nju Jorknë, nuku gjen Shekspir, që ta përshkruajë! Tëmën, kur nuku futmë donjë, t'i thotë kryetarit të Bashkisë të këtushmë, ta dekorojë!

A ia merr, bre, mendja njeriu, se Beni e di sa çape larg është Hotel Plaza me Katedralen e Shën Patrikut, pa qenë asnjëherë n'Aveny të Pestë, pa vënë këmbën asnjëherë në Nju Jork e bile, pa nxjerrë hundën asnjëherë, qoftë edhe një milimetër jashtë kufirit të Shqipërisë?!

Ja ky është Beni, nipçja tem, pe motre!

Me moshën që ka ay, duhet të shëkonte atje për donjë punë. Po ç'punë mo! Hajde ta zemë njeri të qefit: ay nuk u a hedh sytë as çupave, oreee! Lot mënç pas tij, një komshie, shoqe e shkollës fillore. Perri bre, perri! Ta pish në kupë! Ajo vdes pas Benit. Jo or jo! As e ve atë ujë në zjarr ay!. "Muajnë që vjen, nisem" i thotë Beni asaj. çupë e vetme dhe ajo. Tri herë ia ka gjetur helmin në çantët e jëma vajzës. Edhe dofta e zmadhon e jëma, por Beni nuku dëgjon nga ay vesh. "Nuku i lidh këmbët me të, thotë ay, ce i dua të mirën. Miu s'futet dot vetë, të marrë edhe teneqenë prapa! Ma bën me sy, sëkur është Statujë e Lirisë!" Dhe çupa nuk arrin ta afrojë dot djalën, edhe sëkur t'i dilte me këmishkën e hollë të natës! Tjetër punë po të mbulonte donjë vënd

të mirë, me donjë kartolinë pe të Nju Jorkut!

Ja, me kartolinat!… Muret e dhomës, Beni i ka veshur me kartolina, me harta, me skica me statuja lirie dhe me urat ,që të futën nga të katër anët në Menhetten. Kur marrëm vesh se shkon njeri në Tiranë, neve e pyesëm Benin se çfarë do, që t'i dërgojmë me atë që vjen. Nuku do Beni as për të ngrënë as për të veshur, po të thotë me rixha:

- A më dërgon edhe një fotografi? Më mungon ajo ura e Verrazanos!

Duhet të jetë i vetmi bir në botë, që e fton tanë në dhomë e i thotë;

- Hajde baba, të të tregoj urat!

Po ç'vullnet që ka! Po ç'vullnet që ka! Mushkë o mushkë! Ka mësuarë

anglishten aq mirë, sa im bir Fatlumi, pe këtej nga Nju Jorku, si dembel që është, për donjë fjalë të re, në vënd të hapë fjalorë, merr telefon Benin në Tiranë!

Motra më tregon, që Beni me shokë mblidhen në një kafene me një emër që nuk e mbaj mend mirë, se "Urat për Amerikë", se " Urat që të shpjenë në Menhetten". I zoti i kafesë sjell aty xhambazë pasaportash, turistë amerikanë. Djem e çupa aty bëjnë gara për të fituarë çmime, kush di më shumë për Amerikën… Muaj të shkuarë, Beni ish mbyllur zemërvrarë një javë brënda, ce kish dalë i dyti në konkursnë e madh, "Kush e njeh më mirë urën Xhorxh Vashington Brixh?" Beni tem kish bërë dy gabime të pafalshme, në gjatësi të urës dhe në lartësi të saj pe ujit. Teleshmeni jonë e kish nxjerrë urën njëzet metra më të lartër dhe dy milje më të gjatë! Në kafe nuku kish patur vend ku të hidhnje mollën e Beni kish dalë i turpëruarë! "E pe atë tjetrin, si ta mori çmimnë? i kish thënë i jati, - ka burra kjo botë! Ta zuri gojën me ***! Fute kokën në mes të shalëve e rri aty, ce nuku ke më sy e faqe ti, të veç në Amerikë! I pari Peçua, do të të vrasë!" Po çne bre, ta vras!… Tashi Beni ka zënë e del gjene nga kafeneja. Rri aty tërë ditën me shokë e ato muhabete, gjene prapë: -"Flitet që tashi do japën viza amerikane, varda!" thotë njëri. -" Kush ishte sot nga konsullata?"- pyet tjatri. Papo vjen atëças në kafene, donjë shok i tyre e jep njoftimnë: "Tërë këtë muaj nuku do japë viza konsullata!"…

Këto janë xhyxhyxhytë e tyre. Të tërë thonë që janë në Shqipëri me ditë… E ditët u rrjedhën lumë!

Pat ditën e lindjes Beni, aty ca javë të shkuara… I kishnë bërë një darkë, që mos e pyet. Si pe djali të vetëm-o! Nipi kish patur qef që ne ta uromim që këtejza, në sy të shokëve, në darkë e sipër, po unë nuk

arriva dot në kohë, ce pata vonesa me limuzinën. Kur vajta në shtëpi, u sula te telefoni, po Beni më qe zemruarë e nuku donte ta zinte telefonë. Nu e nu! Mezi e pat bindur kunati.

- Harrove ti-o? më pyeti me fjalë të parë, i xhindosur, Beni.

- Po jo bre Beni, - i thashë, - po kam hequr të zinë e ullirit bre, se ishnja gjer

n'aroport të Kenedit e nuku këthesha dot, ce ura ish e zënë. Tërë ato maqina ore, ma mbyllnë limuzinën si në çark. Pe çarkut dilet, pe urës, të më vrisnje, nuku dilnja dot!..

Ay rrinte me telefon në vesh e nuku fliste.

- Po me cilën urë deshe të vinje zotrote, o dajko? më pyeti pastaj.

- Me Trajboro Brixhë, - i thashë.

- Nuk e ve ujin në zjarr ti, o dajko, atë thuaj! hunguronte ay. - Po ce nuku

more Uajtston Brixhë, ti?!

- Uajtstonë?! - hajde gjeja shpegimnë që ta qërrosh me nipçen tim!

- E e, - më tha - nga aroporti, ti mund të merrnje ose atë, ose urën e Throgs

Neckut. Dilnje te autostrada numur 95, për Sauth, edhe në eksit të pestë, kalonje menjëherë në Bronks River, e pastajza drejt e në shtëpi!

Të them të drejtën, unë me timon punoj, po edhe aq me hollësira edhe nuk

para i dimë, bre! Beni e kish tamam ore, por ne duamë kohë t'i mësojmë tërë këto. Gjeninjve nuk ua dalëm dot kaq shpejt. Beni është gjeni!

Renda ta zbutnja:

- E po ja, o Beni, - i thashë, - aq ma previ. Thashë të merrnja Trajboron…

Beni u nxeh edhe më keq akoma. Edhe nisi, hajvani, të më ulërinte që nga Tirana:

- Po Trajboron, në drejtimin Kuins-Bronks, sot e kishe me dy korsi të zëna me

punime asfaltimi! Si, bre, u fute në tym ti?! Nuk e hapni radion e makinës aty, juve-o? Kishnë dhjetë ditë që ishnë lajmëruarë këto punimet, për sonte! Kaqe të humbur, ini-o?! Mirë amerikanët, po edhe ti-o?!

U llahtarisa, kur mos i kem tërë! I kërkova Benit, urxhent, time motër.

- Byrazerkë, vizitoni djalën, se ju iku, moooj!…

Rrëfenja e shtatë: Përse të akuzoja atëhere, or më qafsh?!

Për portierë fotbolli e për hetuesa që të punonin qindin, nuku kish vend t'ia kalonte dot Korçës tonë!…

Kam rrëfyerë shumë, po nuku kam rrëfyerë më të bukurën, atë që më ka ndodhur njëherë këtu, vite të shkuara…

E po kur të qaj tërë, kurrë nuku do ma mirrte mendja se në mes të Pellham Parkut do më fanitej hetuesi im, ay që më pat nxjerrë ujë të zi një herë vaftit! Sefte e pashë kur po zgjidhte banane në Lajdig Aveny. Ay më pa e mbeti. Unë i hoqa sytë. I hoqa unë po s'm'i hiqte ay. E takova më pas dhe nja dhjetë herë të tjera e gjene unë i hiqja sytë i pari. Ay ishte gati të më jepte të njohur, por unë, fësht, tutje! Shtatë muaj rresht kjo punë!

Atë ditë më zuri ngushtë. Unë i ulur në një stol të parkut, ay u dha. Asnjeri tjetër. Unë e ay. Gjene m'u qep ky, miza e kalit, o në ..çkë të sëmës! Gjene me një gazetë shqiptare të zhubrosur në dorë!

E pashë me bisht të syrit. Ay ka mbajtur çapnë e po shëkon këtej nga mua. Këtë rradhë, më duket nuku do më ndahet, thashë.

E nuku m'u nda plaku. M'u afrua e më ndënji një të pështyrë larg. Bëra sikur e vura re atë ças. Po më foli, thashë, do t'i flas! Më foli:

Që je shqiptar këtë nuk e diskutoj më, - ia nisi Taqka. - Të shëkoj gjthnjë dhe,

hë të flas sot, hë të flas nesër!

Unë s'lëviza hiç pe stolit. Po ama, as shënjë që gabohej, nuk i dhashë. E shihnja

unë që Taqka desh t'i shkonte gjer në fund:

Do të më bësh vend të ulem ca-o? pyeti dhe m'u ul pranë. - Dhimitraq ma

thonë, - më tha. - Ore ku jemi parë, bashkë?

Ke parë kështu ti?! - Nuku më mban mend? i thashë me një zë që edhe vetë u çudita, se si m'u ngjir papandehur. - Të më vraç, - tha, - nuku të sjell dot në hatër!

Para shtatë muajsh, kjo do dukej e pabesueshme, por tashi e besova që

plaku nuku më njihte vërtet. - Po mirë-o, - i thashë, nuku më mban, nuku më mban!

Jo, po unë dua ta di, - ngulte plaku këmbë, si mushka.

Dua ta heq nga qafa, po më hiqet ay! - Po më mirë bre, të mos e dish! - ia bëra.

Jo, më mirë ta dij. Dhe pa e lënë brazdën, vazhdoi: - Jemi pjekur donjëherë në Shqipëri?

E po kjo pikë e zezë! Oh, krimb i gjizës! Ky nuku më desh mua, jooo! Këtij i duhej donjë hundë lesh që t'i rrëmbente një dru, që t'i binte shtatë herë e t'ia nëmëronte një! Gjene thashë, hajd t'ia shkund kujtesën nga rrodhet:

A ke qënë hetues, zotrote? - ia prita si me tokmak. Ay u hutua e po më

përpëliste qepallat si guak. Shtyje dhe ca Peço, i thashë vetes. S'e sjell dot në hatër-o? Në burg të Korçës, e kujton tashi, besoj!

Të ish donjë tjetër do ngrihej e do bëhej def, me bisht në shalë, por Taqka

duket e ndjeu, se unë të hanja munë, jo të nxirrja inatet!

Mos more! Të kam bërë hetimnë? Të kam marrë në pyetje, ëh? - Të thoshe ti,

Taqkës nuk i delte e keqja. - Eh moj e kaluarë e hidhur!.. i binte gjunjëve. (Tëmën, thashë, do të zerë të më qajë këtu!) - Mo më thuaj që të kam torturuarë! tha dyke m'u lutur.

Po të duash nuk e them-o, - i a bëra, - po e vërteta është se…

Hajde regjim i poshtër hajde! psherëtinte plaku që nga thellësirë e shpirtit e

nisi ta shajë me rrënjë e me degë diktaturën: - Dhe me siguri i ke ngrënë shtatë vjet prapa hekurave, në palcë të rinisë! I ke ngrënë, i ke ngrënë! Ah moj diktaturë e fëlliqur ç'ke bërë! Dhe kthehej nga unë: - Po a je mirë? Ncë-ncë! Përse të akuzonja, mor aman, më qafsh?

Do të ta them-o, posi, i thashë: Kot fare! Se, gjoja, dëgjonja "Zërin e

Amerikës". Se, demek, desha të arratisça dhe të vinja këtu në Shtetet e Bashkuara…

Plaku vazhdonte ofshamat e pikëlluara rradhë-rradhë, gjer u kujtua se më zu me

presh në duar. Nisi të zgërdhejë e të më tundë gishtnë, me qortim pe mësuesi.

- Në fakt, ja ku je n'Amerikë! Hë-hë! Nuku paska qënë kot!

- Shpifje bre! Atëhere nuku kishnja dërmend! ia preva.

Këtë, as tani s'ta pranoj. ma previ dhe ay dhe unë e pashë, që kot i kisha

ndënjur ftohtë, pasi asgjë s'e pengonte Taqkën të kënaqej me mua, si me një mik të vjetër. Ma lëshovi firomën në vesht e më pështpështi ngadalë, sikur Sigurimi të na paskej ngjitur përgjuesa edhe dëpër stolat e Pellham Parkut: - Tërë bre, tërë ne e ëndërromim Amerikën, atëhere! Si ju që rriheshit, edhe ne që u rrihmim. Hë po diktaturë e poshtër, që na mori më shumë se gjysmën e jetës! - Na e mori… - ia bëra me zor pas tij. - Ah moj diktaturë e mallkuar! Ah o sistem maskara!

- Maskara, - i mbajta iso pa qef e fillova ta marr inat veten, ce jo vetëm nuku po i lanja borxhet, por po i vinja edhe pas avazit. E bile, dyke dashur mos ma merrte fjalën "maskara" për veten e tij, nxitova ta përsëris gjene: - Sistem maskara!

Më erdhi turp pe vetes, kur të qaj tërë. Tëmën, thashë, po unë pse nuk ia ndërroj këtë *** teme, po e le të dërdëllisë dyke sharë bot e bot diktaturën! E pyeta si ia kalonte tashi.

Me halle shumë. ma bëri dhe lëshovi një derro psherëtimë, sa thashë se

dha shpirt. - Po tashi, - më tha, - që amerikanët më dhanë strehimnë, sikur më mbarë po më vete.

Rrufenë e kisha pritur, këtë jo! Deshnja unë ta linja temën, po s'më linte tema mua. Kushedi sa do t'i kem çakarritur sytë, se Taqka më kuptovi.

- Ce habitesh-o?.. Tërëve neve që e kemi urryerë diktaturën, na e dhanë, - tha.

- Po ja, - iu qava, - mua nuku po ma japën akoma!

- E po ti dofta nuk e ke urryerë aq sa neve të tjerët, - ma shpegovi dhe desh ta nxirrte shkaknë: - Ja, pasi … mbaruamë punë bashkë, atëhere, ç'ke bërë? Unë nisa t'i tregoj që pe ditës që pranova akuzat. - Në fakt, - ma previ fjalën Taqka, - jo që të mburrem, po me mua, të tërë i pranonin akuzat. Hë, më fal! Pastaj, ç'bëre?

- Ato të shtatë vjetët!.. - iu përgjigja e teksa plaku vazhdovi ta shante me rrënjë e degë sistemnë, unë desha ta vërtetonja akoma: - Vërtet nuku më mbanje mend?!

- Po kuuu, bre! u shfajësua me fytyrë qarramani Dhimitraqi. - Sa kam kaluarë unë dëpër këto duar! More, more, more! Të zestë male që s'piqen dot, pa njeriu me njerinë u pjekërka! E pyeta se si i kish vajtur

filli atij më pas. - Regjim i poshtër, bre bir, - tha. - Pasi mbaruamë punë bashkë, nuku më rreshtnë trasferimet! “Na duhet një hetues i zoti atje: shko Taqkë! E ka kyçur njëri gojën këtu: hajde Dhimitraq!”.. E kështu gjer sa suallmë demokracinë…

Të na shihte njeri tok, do ta zinte lemeria. Të ngjanim ne, or byrazer, si dy miq të vjetër që kanë kaluarë të tharta dhe të ëmbla tok. Kur mos kem babanë, dukshim në stol tamam siç e thonë këta kllasikët e rinj të demokracisë, si dy bashkëvuajtës, që po shamim sistemnë, që na kish bërë bashkfajtorë e vazhdomim me pyetka, për rrugët që na kishnë shpënë larg njëri tjatrit.

Po tani-o, me se merresh? pyesnja unë, bashkëfajtori, të gjorin Taqkë, -

nuk u ke kërkuarë donjë punë si hetues, këtyre të Amerikës-o?

- Uell… - ma kthente me një fjalëzë amerikane bashkëvuajtësi im, që si tashi e sjell në hatër, ashtu me mëngë të përveshura në hetuesi, - në fakt, ma propozuanë. “Nuku kam fuqi, bre, u thashë, mua më ka drobitur biruca”…

- Biruca?!!! - Rrufeja e dytë, kjo! Këtu më kërcyenë mua. I butë i butë, po kjo ishte të qaje me oiii!.. Njëmijë susta më shtynë përpjetë, drejt e më këmbë: - Po tinë nuku the që ke qënë në burg!

- Nuku thashë unë, po ama e thotë shkresa! ma bëri ay pa u ngritur pe vendit. - E kur e thotë shkresa me firmë e vulë, zere se ke qënë! Hë mo derëzi, se tërë kemi vojtur në atë skëterrë!.. Shkresën ma dha një njeriu im, në Komitet të Përndjekurve. Ay ma mbushi e unë ua paraqita këtyre…

Tëmën-o, për atë ditë m’i paskëshin mbledhur të tëra çuditë! - Njeriu yt?! Ke patur ti njeri nga fisi, të përndjekur?! ulërita.

- Kush mo tha, nga fisi! Taqka vazhdonte të fliste ulur, avash avash. - Tërë ata të përndjekurit e komitetit, i kam kaluar dëpër duart e mia.

E po kjo…kjo nuku është e drejtë, bre! po shfrynja unë. - Ja thuaj të drejtën!

Biseda e ngrohtë tani na kish lënë shëndenë. Unë zjenja, ay valovi i pari! Vrëng,

përpjetë dhe më erdhi para turinjve!

- Cila, mo, nuk është e drejtë! Cila?! Patriot, patriot, po… nuku të duroj unë! Mbylle kamaren e rri rehat aty! Tani po ma kujtonte tamam atë Dhimitraqnë e parë. Nga e kish fshehur tërë atë zë, o e vrafshin me bukë në gojë! Sokëllinte o sokëllinte: - Nga juve, më tha, i

patmë ata dyzetepesë vjet, që kur i kujtoj më dalin mornicat mbi pantollona! - Nga neve-mo?!!! i a bëra. Nuku na e ka fajnë njeri, oreee! - ia bëri, - vetëm juve!

Po ç'faj u kemi neve mo?! Juve na shqeptë me hu! i u këtheva unë. Na

futët spica dëpër thonj.. Na futët vezë dënë sqetulla. Vezë nuku gjenje në dyqane, ce i mbanit juve bre, për sqetullat tona! A duronim dot neve-o …?

Unë bot e Taqka qyt: - Të duronit-o, posi! Kur është fjala për liri e demokraci, për popullin, njeriu duhet të durojë, oreee! Po të rezistuakshit juve, nuku do na kish zgjatur aq shumë diktatura. Ja mo ti, ti: a ishe fajtor ti, kur të dënova? - Asnjë çikë! i thashë pas njëzet vjetësh! - Sigurisht, që nuku ke qënë - tha edhe ay, po pas njëzet vjetësh, - po a e pranove fajnë? E pranova… - pranova kokunjur unë.

Këtu Taqka më ulërivi, sa në dyzet vjet, ulërimë të tillë s'pata dëgjuarë. U tund

Pellham Parku o në …çkë të sëmës!

Po pse e pranove, mor… mor…?! Po unë kisha qef bre, t'u a përplasnja në

sy, shefave të mij e t'u thoshnja: "kot ma kini sjellë këtë, oreee! Ky është pa faj!"

Po t'u thoshnje -o, posi!

Po ç't'u thoshnja unë, mor ta thëntë prifti! xheç më mbyti hetuesi im. ç'tu

thoshnja, kur ti e pranonje menjëherë! Ta hanja unë-o?! Të merrnja më qafë djemkat e mi-o? Ju marrtë dreqi juve, ljepuj! Na e bëtë jetën zeher. Na mbajttë më këmbë gijthatë palo regjim!… Do kishimë ardhur n'Amerikë, tridhjetë e ca vjet më parë!.. Do kishmë hapur donjë biznes.. Ju ngrëntë murtaja, ju ngrëntë!

Iku me kacabunj të ngritur dyke sharë e turfulluarë. Dhjetë çape e kthe kokën, dhjetë çape e kthe kokën! E ma hidhte mua flakën e syve, sëkur i kishnja vrarë babanë, sëkur i kishnja shkatërruarë jetën.

Unë mbeçë si gallof e për atë Zot, në po e kuptonja, se ce nuk e kishnja më Taqkën aq inat, sa ç'e kishnja mote të shkuara?! Dy gjëra ishnë: o ay kish të drejtë ose ma la mua prapë pilafnë!...

Rrëfenja e tetë: Ca fiq për një kitarë xhazi

Kur më erdhi djali, nuk pat harruarë të merrte me vete edhe kitarën e tij. E futmë djalën në klasat e këtushme. Ay na i rënke kësaj kitare edhe në shkollë. Dhe aty e mora vesh këtë, kur vajçë të takonja mësuesët, sipas ftesës që bëjnë shkollat.

Ishte e premte paradite dhe shkolla i kish hapur takimet me prindët që një natë më parë. Sefte takova mësueskën kryesore. Zonja Frensis më priti me buzë të qeshur, që sapo unë u futa në derë me djalën për dore. Ëmbëlsirë e tërë oreee! Foli mirë për tim bir, nga kreu në fund! Më tha që anglishtja e Fatlumit bëhej çdo ditë më e mirë e më e fisme: një ditë dhjetë fjalë, të nesmen dhjetë fraza e tani ajo lumturonte kur e shihte djalën të zihej me nja dy rusë, në anglisht! Unë i merrnja ca kohë asaj, që tia përkthenja tim biri fjalët e mësueskës. Dhe djali gëzohej, kur merrte vesh se ay ditkërke anglisht.

- Kam një porosi të veçantë, - më tha në fund Frensisi. - Që mbrëmë deri sot, mister Shorni ka zbritur pesë herë për të pyetur a kini erdhur ju. Po mos u shqetësoni! - shtovi ajo. - Mister Shorn po e fut Lumin në orkestrën e shkollës dhe do që t'i njohë babanë!

Kur, hop, mister Shorni u shfaq te dera për herë të gjashtë!.. Njerëz të edykuarë

bre… Shornit i qeshte fytyra. Këtej, Frensisit i llamburiste. Mëuesi më shtërngovi dorën mua, i fërkovi kokën djalit, që shkurt edhe ay i thërriste Lumi e na mori lart në kabinet të tij. E tërë mirësjellja e Shornit dhe ajo e Frensisit, të bënte me krahë, sa t'i thoshe vetes, tashi mbyll sytë e rrugë e mbarë të qoftë në botën tjatër, o Peço Jani! Bëre këtë goxha djalë, pirdhu tashi, se në historinë e kësaj bote këtë detyrë pate!

Shorni i tha Fatlumit të merrte kitarën. E Fatlumi fillovi të cimbiste telat me ato gishtkat e tij si kleçka, dhe të këndonte me zëth të hollë:

Dua mëngjezet e majit,

kur këndon bilbili bukur…

Shorni më shëkonte mua, sëkur atë këngë ia kish mësuarë djalit ay e jo unë! Sa kujtime më zgjonte ajo kitarë e vjetër e ajo këngë, ehu! Djali vazhdonte:

Dua lulet e fushësë,

në mëngjes, kur janë me vesë…

Xheç më duallë kokërdhokët, kur në refren hyri të këndonte dhe

vetë Shorni e iu bashkua djalit:

Po nga gjithë ato më parë,

dua më shuuumë, Shqipërinë.

Dua të vejë ajo mbarë

edhe për jetë, të ketë liriiiiinë!

Amerikani mbarovi këngën për Shqipërinë e m'u drejtua mua:

Juve, ju pëlqen?

Po, - i thashë.

Vetëm "pooo", mister Jani?! m'u mërzit Shorni. "Është fan-tas

ti-ke! Megjithëse, ku dihet, ju mund të keni atje këngë edhe më të bukura.

Pastaj ay më vuri në dije, për orkestrën e shkollës dhe se Fatlumi tashi duhej të

stërvitej me kitarat elektrike.

"Hë, thashë, këtu dil! Ke hallë e orkestrës ti, vëlla! Pa na e mban, a nuk na e mban ne xhepi kitarën elektrike, nga ay krah s'do t'ia dish ti!"

Dëgjo o mister Shorn, - i them.

Po ay s'më la ta shqepnja.

- E di, ajo kushton. Ju kini tre fëmijë… Po ne këtë do ta zgjidhim. Unë në shtëpi kam dy kitara të tilla. Njëra nga ato, nuk më duhet…

M'u prish qefi. Më iku tërë ëndja që ay e Frensisi më kishnë krijuarë gjer tashi. Djali këtej nuku më linte rehat, ce deshte t'ja përkëthenja. Hej bela! Nuku desha t'i thosha tim biri, që zoti Shorn, kish një kitarë e deshte të na e shiste. Nuk i thosha dot që ay kish rënë në ujdi me zonjën Frensis, që sapo të gjenin një qorr pe Shqipërie, tja varrnin atij më qafë të bënte xhaz me iso; që ky do t'i jepte mësueskës përqindjen që i takonte; që unë nuku dinja si të dilnja pe këtij kaçamaku… E që: nga vajta e ta mësova atë kitarë, që të bësha lëmsh me gjithë telat e saj!

Më kishnë thënë, "në do matrapazë të klasit të parë, i gjen në Nju Jork! Janë aq të zotë, sa kur u hyn në dyqan, të blesh një palë lidhëse, të shesën edhe këpucët e dimrit edhe gëzofnë!" E dinja këtë, por që të ishnë dhe mësuesët kështu?! Gjithato buzë të përveshura, gjithato fjalë për talentin e Fatlumit! Po si o në … çkë të sëmës, për të të shitur kitarën e xhazit që i ka zënë derën, të vete tjetri e të mëson sa fëmijë ke e mëson për mënç ca fjalë shqipe, që të më pëllasë këtu tok me

djalën “dua më shumë Shqiiii -përii-iii- në”! Tërë e duan Shqipërinë e shqiptarët ore, që t’u shesin ç’u kanë zënë depot! Gjëja e parë që bëjnë këta biçimët e *****, janë buzëqeshjet, që nga njëri vesh te tjetri. Me ato viza të hyjnë në zemër këta! Nuku paskej faj Rezi i gjorë, që njëherë e më dy ditë thotë, që ne s’jemi për këtu e duhet t’ia mbathëm prapë, nga thembrat majat!

Neve o mister Shorn, - i them copë, - nuku ta blemë dot atë kitarën!

Po jooo! - nxitovi ay. Unë nuk them ta blini. I gjithë meraku im është, a kini

kushte në shtëpi?

Ato djersët e shkreta unë i kam me sustë, po belaja është që sustat m’i shtypën

të tjerët.

E me sa këste? e pyeta.

Po ç’këste! tha ay. Po pranuat ju, si prind, kitara është tuaja! Unë

e dhuroj. Djali duhet të rrijë me të në dorë, edhe në shtëpi.

“Tëmën, thashë, ku jemi katandisur! Ce o me dhurata do ta kalojmë këtu neve”?!

Më hipi damari i budallajt:

Mirë, mirë, po sa bën ajo kitara? Sa e ka vlerën?

ç’rëndësi ka sa e ka vlerën e sa bën! ngulte këmbë Shorni. - Unë e fal e ajo

s’kushton as edhe një cent!

Po nuk e pranonja unë tashi! “Këtyre u them tregëtarë unë ore, po mendonja. Këta e dinë që ka njerëz nga ca popuj, që po u dhe një gjë falas, pa para, atyre u ndizet fitili i sedrës dhe atëhere e derdhën paranë lumë, edhe kur nuk e kanë në plan”!.. Kjo po ndodhte me mua. “Uëu, uëu! Ma shiti xhambazi, kur mos kem babanë”, po thosha me vete.

Unë e shoh, - më tha qetë Shorni. Ju nuk doni ta merrni dhuratën teme,

por dua t’ju shfaq një sekret: unë i kam një borxh të pashlyeshmë këtij Fatlumit tuaj. Unë kam qenë njëherë të vetme në Shqipëri. E s’besoj se do të vete më. Kur isha atje, ky djali juaj më ka bërë një dhuratë të madhe, më ka bërë borxhli!

çfarë po thotë o baba? më thosh im bir, që Frensisi ma kish mburur

për

përparim në gjuhë.

Rri ore ti djalë, - i buzëqeshnja unë atij ngaqë s'i shtrëngoja dot dhëmbët.

Më lerë rehat, të marrtë e mira, ty e kitarat e tua! Unë nuk po ia zhdredh fillin për vete, ti thua ç'thotë! Marr vesh unë se ku do dalë ky!

Shorni nisi të rrëfejë se na qënke vullnetar në një organizatë bamirëse

refugjatësh. Më nëndhjetedynë, na paskëshin bërë një shëtitje dëpër ca vënde të Ballkanit. Hallë e kishnë te Bosnja, po ata paskëshin shkelur edhe Shqipërinë me Kosovën, për t'i hedhur një sy gjëndjes. Ngjarja që e kish goditur, i kish ndodhur Shornit në Elbasan, sapo kishnë nisur të ngjitnin Qafën e Kërrabës, drejt Tiranës.

Shtatori qe më të hyrë dhe mbaj mend tregovi Shorni, - që pat rënë një shi i

bukur e i shkurtër, që pat lënë një ylber që s'më harrohet. Më të përpjetë, buzë xhadesë, kishnë dalë fëmijë të veckël, që mbanin përpara ca shporta me fiq, që ua shisnin udhëtarëve. Shoferi jonë xbriti, bleu ca dhe na i ndau të gjithëve.

Shorni pranovi se në jetë të tij, nuku pat ngrënë fiq si ata. Po ç'fiq! Në atë vend, mësuesit i kish bërë përshtypje, që edhe domatet edhe pyperkat ishin më të ëmbla e çdo prodhim kish një shije, që s'e pat gjetur gjëkundi mbi faqe të dheut. Te fiqtë i kish mbetur mendja. I qe lutur përkëthyesit, që po të gjenin fiq të tjerë rrugës, të blinin përsëri.

Gjetmë, - tha ay. - Në këthesë të parë ishte ky, Fatlumi tend, që kish dalë e

shiste fiqtë e tij! Ja me këtë trup, me këto sy të qeshur. Ky, tamam ky. Shoferi xbriti e nisi të haej në pazar me djalkën. S'lëshonte pe djalka, ta vrisnje! Pyeta, si qe puna. Më thonë se çuni e mban lart pazarë, se i ka fiqtë më të mirët nga të tjerët. Xbres tok me përkëthysin dhe i zgjat djalit një njëqind dollarëshe. Kush është ky? pyeti djali, shoferë. Është i huaj, i thotë shoferi. çuni e mbështolli mirë shportën e ma zgjati, po dollarët nuk i desh. Në asnjë mënyrë! Hajde këtu, i them përkëthyesit, pyete e ma këthe anglisht fjalë për fjalë si do të më përgjigjet. A u zure me shoferë për pazar, - i them. Po, - tha djali me duar në xhep, - po me këtë jemi të këtushëm. Po unë e kam rrogën të madhe se të shoferit, mua përse s'do të m'i marrësh? Ndryshe ti, - tha djali, - ti je mik këtu. Ishte veshur si mos më keq e nuk i desh 100 dollarët, që me kursin e kohës, shtëpia e tij e vinte

festen mbi sy një muaj! Do t'i marrësh, - i them. Nuk i marr, - më thotë. E ndiqnim djalën e nuk ia futnim dot në xhep, se xhepat i mbante shtërnguarë me doçkat e tij. Djall, ç'interes kish vallë ky fëmijë, që të më linte mua bujarisht tërë mallin që po shiste?! Shëko, - i them, - nga unë mos prit gjë donjë ditë tjatër, se unë nesër e le Shqipërinë e nuk vij kurrë më! Rrugë e mbarë të qoftë! - më tha, ma bëri një përshëndetje me pëllëmbën e tij të vockël dhe iku me vrap dyke zbritur një rrëpirë me bar. Na i la fiqtë në dorë. Hipmë në makinë dhe s'flisnim asnjëri. M'i zuri fiqtë në fyt. Më tronditi. Më tronditi shumë. Këtheva kokën, po djali nuk shihej më…

Shorni mbarovi e unë nuku flisnja dot. Këtej historia më kish prekur, andej më

vinte turp për mendimet që blova aty më parë për këtë mësues të lartë. Shorni fliste për Fatlumnë, por e ndjevi që unë ia kuptova përgjithësimnë e vogëlushëve shqiptarë, të cilëve u ka mbetur ay mallkimi i bukur që të mos heqën dorë nga bujaria edhe pse mbeten krëckë, të varfër!

Shorni ndjevi edhe atë, që unë pe mallëngjimit, nuku nxirrnja dot zë burri. Më

kthevi kurrizë që të mos shëkonte dobësinë time, afrovi djalën, ia futi kokën në gjoks të tij dhe po i përkëdhelte leshkat.

Kur fap, e pashë këtë, shitësin e fiqve, që m'u shfaq këtu në shkollë, me gjithë

kitarën e tij në krah. E tani unë do t'ia kthej borxhin. Do t'i dhuroj kitarën time. E le të guxojë, po mundi, të më zgjasë para!

Babë e bir u kthyemë në shtëpi pa folur. Shohim hi ore hi e shkrumb më të katër anët! E kur gjejmë në grumbull të hirit, donjë thëngjill që ndrin dhe ngroh, nuk e besojmë. Na është hirosur shpirti, na ka bërë jeta… Sa turp, sa turp!

Të faleminderit o çun i panjohur pe Elbasani, e paç jetën të bardhë!

murmurisnja me vete dhe më dukej se ende nuku kisha zë. Le që ç'më duhej më shumë?! Kur s'ke më fjalë për të thënë, kot qahesh për zë!…

Rrëfenja e nëntë: Si fsheha mes shalëve dyzetetremijë dollarë

E po, se njerëzit presën që të rrojnë me paratë që u vijnë nga mërgimi, unë nuku kam pse të heq ato që hoqa!

Ashtu si vajçë unë në Shqipëri, njeri mos vaftë! Edhe me Karavellë të më ftojnë, nuk udhëtoj më si herën e parë: Nju Jork-Vjenë, pastaj Vjenë -Tiranë. Në të këthyerë një stacion më shumë, Tiranë - Prishtinë, Prishtinë - Vjenë, aty duhej të flinja një natë dhe të nesmen t'ia mbanja për Nju Jork.

Telashet filluanë që kur mua më hëngri goja mjaltë e vetëm Tajmsit nuk i thashë ta botonte lajmin, që Peçua do vinte një vizitë në Korçë. Dy ditë para se të nisesha, valicat i kisha dëng, me porosira. Vetëm për plaçkat teme, nuk kish vend në to!

Pastaj do më duhej të shpinja Korçë, jo pak, po dyzetetremijë dollarë! …çkë të

sëmës! - thashë. Korça do t'u bjerë këmbanave, kur të më shohë përpara Shën Gjergjit! Merre me mend, më kish dhënë para edhe Vançua i Ciles! Tjatër: Koçi i Mitropolisë, Leko Lajthiçka, Zihni Pepellashi e Marenglen Zëmblaku, sa për të treguarë ca, pe atyre që asnjërit s'i vinte mëndja se u dërgokshin para familjeve!

Më therrtë mua në dinin këta njerëz që kish n'Amerikë banka e axhensira, që e bënin më kollaj këtë punë! Të them që deshnë të kursenin paratë e postimit?!.. Mbase bre, po historitë e hidhura me shtetnë, me matrapazët, i bënin hallexhinjtë të kishnë më besim te Peço taksisti ,se te tërë bankat e Shqipërisë e të Amerikës!

- E po tashi, si do t'ia bëjmë-me? - i them Rezit. Me kaq para, unë nuku vete i

gjallë gjer Korçë!..

Ishnë të tëra qindshe, nga ato me turi të madh. Bëhej një xhumbë o byrazer, që

mos e pyet!

- Do të t'i fut në një qeskë plastike , - tha ime shoqe. - E do t'i mbash në mes të

shalëve, Peço!

Ish vend i lik, po më të përshtatshmë vend, s'gjenje dot. I mban njeriu në xhep të brëndshmë, po xhaketa hiqet, harrohet gjëkundi… Plys që, kontrollorët në aroporte të shëkojnë për armë. Këpucët t'i zbathën, si ia zbathnë një ndihmësi të Predidentit. E po të gjetnë

paratë, varda dëpër gjyqe, pastaj!

E kam të shkathtë gruan. I bëri ajo paratë një alamet shuku, që ma lidhi me ca llastiqe në krye të shalëve. Ca llastiqe të tjerë m'i lidhi në bel e ata nuk e linin xhumbën e parave të më varrej poshtë. Kështu edhe mbaheshin, po prapë, bre, binin në sy, e binin goxha!…

Kur u futmë n'aroport, na bënë më pak kontrolle nga sa kishmë menduarë. Ca gra të sjellçme, veshur me uniformë të aroportit, më shëkonin me respekt. Këtë respekt e dëftenin nga që ishnë të edykuara, por Rezi, ashtu e fryrë pe të qeshurit, tha, që ato nuk m'i hiqnin sytë nga shuku i parave.

- E po pasanikët kudo nderohen, - thashë unë sëkur nuk e kuptova romuzë.

- Gratë, nuk i dinë si para ato! mërmëriti Rezi… - Por kujdes, se ti një e dy, i

shpie duart mbi dollarët, e dukesh si horr!..

- Më venë duart vetë i pështpërita unë. Ti qesh, po është përgjegjësi e

madhe. Vetëm Vançua i Ciles më ka dhënë dymbëdhjetëmijë, moooj!

Ajo, mbase nga që kish merak e desh të sigurohej, më hidhte nga një sy këtej poshtë, po nuk e mbante dot të qeshurën. Edhe kur u ndamë te dera që më shpinte në bark të aropllanit, tek ecja rëndë rëndë e me gjith atë shuk përpara, ia bëra sime shoqe, me dorë. Ajo dyke më ndjekur me sy, pati një rrebesh pe lotësh, po nuk e mora dot vesh: nga të qarët a të qeshurit…

Unë nuku kam hipur shpesh në aropllan, por kur hyj në të, sëkur shkel në një tempull. Aq e përsosur bre, më duket teknika këtej nga Amerika, sa as e mendoj kurrë se do rrëzohet donjëherë aroplani, që më mban mua! Gjithë ç'rrëzohen, më duken o filma të Hollivudit, o propaganda të Enver Hoxhës, që na rri akoma varur dëpër qiejtë e truve tonë!

Aropllani u ngrit, po ish natë dhe unë shëkonja poshtë ujëra e drita të bëra mishmash. Kisha përpara një ekran të vockël dhe e ndiqnja atje aropllanë tonë në një hartë: si rrëshqiste porsi pikë e vockël mbi xham të ekranit, si kalonte Bostonë, si u afrohej cepave të Kanadasë, si kalonte mbi ishujt e pabanuarë të detrave të veriut dhe si do t'i afrohej Islandës…

Darkën, ato stjuardeskat austriake na e dhanë në kohë, me organizim të përkryerë. Unë nuku kam udhëtuarë aq, sa të mos kem nevojë akoma të shoh më të majtë e më të djathtë, se si hapet kutia

plastike e ushqimit, si nxirren pironjtë e si xhvishet patatja e zjerë. Më të majtë kishnja dritarkën e aropllanit, më të djathtë një zonjë në të zeza, që më bëri të psherëtij i lehtësuarë, kur m'u unj pranë. Se kishnja frikë mo më ulej donjë kopuk dorëgjatë!. Me bisht të syrit, shëkonja ca duar të bardha, me thonj të manikyrosur, që hapnin qeskat plastike, - që unë vetë pa parë të tjerët, u hanja mender munë, jo i hapnja!.. Ia ndoqa lëvizjet doçkave të zonjës, me kaq dhelpëri, sa i mësova të tëra: si ndizej drita, si ndrroshin kanalet në ekranin që kishmë secili më vete… Tamam si një nxënës fshatar i kujdesshmë, që nuk të le të kuptosh, se nuk është pe kryeqyteti!

Agu e hodhi dritën më shpejt se ngaherë. Aropllani dukej se e pat lënë qiellë e tashi ish bërë vapor, që lundronte në një oqean pe qumështi! Mbi Irlandë, zonja me të zeza flinte akoma, po unë nga respekti i saj dhe nga meraku i parave, nuku kishnja lëvizur asnjëherë dhe nuk e kishnja shqetësuarë atë. Të mos paskësha tërë atë xhumbë për të ruajtur, nuku do më kish shpëtuarë që ajo gruaja me të zeza, nuku qe hiç e moshuarë. Por unë e kishnja vënë re zonjën veç me një rregëtimë të syrit e aq.

Përmbi Francë, gruaja me të zeza u zgjua dhe atëhere unë guxova ta bezdis, që në tërë atë fluturim, të vinja së paku njëzë herë në banjë. Ajo nuk u ngrit të dilte në korridorthin e vockël. U mjaftua dyke tërhequr trupnë prapa, aq sa e linte kulltuku. Kalova me pak lehtësi e me shumë elegancë, por nuk arrita dot që shuku i parave, të mos e cikte fare zonjëzën! U mundova po, aha!.. Ja mos i kem tërë, që qe e pamundur! Vetëm kur më pa paratë, që e fshiknë cazë, ajo erdhi në hatër se ç'mashkull të veçantë kish patur përkrah, për shtatë orë që pe Nju Jorku!

Kur po këthesha pe banjës, e pashë gruan me të zeza, që qe ngritur e seç kërkonte në çantët që e kish mbi kokë. Dita me djellë mua më kish bërë më trim e zonjëzën e bënte të dukej më e re dhe më e re! Më pa që po vinja e në vend që të priste, ashtu më këmbë, sa të hynja unë në vendin tem, ajo m'u duk se nxitovi të ulej. E gjene ma bëri kalimnë të ngushtë. Si t'ia bënja?

- Mos doni të rrini afër dritares, tashi, që u bë ditë? e pyeta anglisht sa për ta

shtyrë më andej. - Gratë, çoku e kanë qef dritaren, - e kujtova.

- Po, po, por jo unë! tha ajo me nxitim.

Kalova dyke u kujdesur që dyzetetre mijë dollarët të mos e shtynin në ngasje, por

kur ata i kaluanë shuk, përpara syve, pashë që zonjës, - ja, kur mos kem babanë, - i iku e bardha e syrit dhe bebëzat iu zmadhuanë! Kur

unë zura vendin tem, ajo më buzëqeshi edhe më bëri pyetkën më njerëzore, që më vraftë Perëndia, në do ma kish bërë, po t'i kishnja kaluarë të dy herët me kurriz nga ajo!

- Për ku udhëtoni, zotëri?

Ishte bullgarkë dhe quhej Janka. I shoqi i kish vdekur tetë muaj të shkuarë, në

Nju Xhersi, ku punonte si programist kompiuterash. Janka shkonte te e motra, që punonte në një përfaqësi bullgare, në Shkup. Vetë Janka ish pa punë, kurse mua më erdhi zor t'i thoshnja jam shofer dhe i thashë që isha pedagog, në një Strehë fëmijësh me të meta dhe jetimë.

Bullgarka më besovi. Gënjej e nuku lodhem kurrë unë,ore! Nejse, u llafosmë gjatë, megjithëqë ajo anglishten e fliste çapra-çupra. Unë e flisnja cazë më mirë, ama kuptoshim për bukuri, ce dy veta që e flasën keq, kanë më harmoni e kuptohen më mirë se dy veta që e flasën perfekt. Folmë për rrugën e dolli që nga Vjena në Nju Jork, do këtheshim në të njëjtën ditë e orë e me të njëjtin avion.. Por ama do të kalomim një natë të tërë në Vjenë.

- A keni juve vizë transit, për donjë hotel të Vjenës atë natë? më pyeti

vejusha.

- Jo, - i thashë. Po ju?

- Nuku ka problem, - qeshi ajo, - se pashaportat bullgare tani, nuku kanë

nevojë për viza, gjithandej!

Një pedagog, si po shitsha unë, duhej ta dinte këtë gjë, o e vraftë Perëndia!

- Edhe unë, - i thashë, - e marr kollaj në konsullatën austriake të Korçës! (Që

nuk ekzistonte hiç, edhe këtë, një pedagog pa të meta i fëmijëve më të meta, duhej ta dinte!)

Ia thashë me kaq kakapërllëk, sa pa dashur vura duartë edhe mbi xhumbë. Por menjëherë m'u kujtua paralajmërimi i sime shoqe dhe i hoqa sakaqë pëllëmbët që andejza.

Por ishte vonë. Bullgarka e kish vënë re dhe se si nisi të më vështronte.

- Përse nuku vini me mua gjer në Shkup? propozovi vejushka. Korça është

më afër që nga Shkupi, se që nga Tirana!

I mallkova dhe një herë ata që më bënë të udhëtoj me tërë ata dollarë në

mes shalëve. Të mos i kisha ata, nuku do më qepshin kështu vejushkat e botës! U shfajësova, ashtu, sa për të larë gojën dhe e këputa fillnë e lëmshit, se për fat, austriaçkat na suallë mëngjezë. Unë kërkova një çaj të nxehtë. Nga një lëvizje e pamatur mirë, m'u derdh tërë çaji, ashtu si qe i valë, në prehër! Po të mos më mbronte xhumba e parave që po prisnin gjysm'e Korçës, unë do të kishnja ulëritur. Por vejusha e gjorë kish akoma përfytyrim normal.

- Auuu! ia dha ajo pallmës dhe nuku pati kohë ta bënte anglisht thirrjen e

Zotit, po tha: Bozhe!

M'i dha menjëherë picetat e saja. Rendnë stjuardeskat e u mblodhë

të tëra mbi shuknë e parave, sa me zor po shtynja njëqind e ca thonj bullgarë dhe austriakë të manikyrosur, që deshnë të më trazonin aty, ku unë nuku deshnja kurrsesi!

Në Vjenë, para se të ndashim, Janka më vuri t'i premtonja se pas dy javësh do

takoshim po aty dhe më pas, do hamim darkë bashkë gjëkundi, fshehur pe botës, në donjë restorant buzë lumit që çan Vjenën.

* * *

Nuku besoj në jetë teme, të më qëllojë më, të bëj rrugë kaq të vështirë. Në Tiranë, jo keq: më shumë më shëkonin nga valicat. Kurse në Poradec, nuku m'i ndanin sytë nga kapella dhe syzet e diellit.

Më e madhja më ndodhi Korçë.

Më të hyrë të qytetit, autobuzë na e ndalovi një skuadër me polica dhe ata na kërkuanë të xbrismim të tërë. Xbritmë. Na vunë më rradhë e filluanë nga kontrollet. Më duket dyshonin për donjë që vinte i armatosur. Ama nuk i kontrollonin të gjithë, por veç ata që u zgjonin dyshime. Unë dridhsha. Gjithë jetën kam ndjerë që jam i dyshimtë. Një herë, vite të shkuara, në zbor, njërit i vodhnë orën dhe pesë paqeta Arbëria. Suallë një qen, që i gjente hajdutët me hundë. Qeni erdhi drejt e te mua e nuku shkulshe pe vendit! Hajduti i vërtetë më pas u gjend, po mua nuku më hiqet nga mendja kurrë, se përse nuku me ndahej qeni! Edhe tashi n'Amerikë, kur paguaj gjashtë dollarët për të hyrë në Urën e Xhorxh Vashingtonit, trembem, se tamam mua nuk do më hapet trari për kalim. Mani e persekutimit, bre!

E nuk u gabova: sytë e skuadërkumandantit ranë mbi mua.

- Ti!.. ia bëri. - Bëj përpara! (Bëra). Pe nga vjen-o?

- Pe Amerike, - thashë un'i ziu.

- Ke pashaportë amerikane-o?

Të gënjenja? Ja iu shkrep e më tha: "pa dal'të ta shoh!" Do më shpinin në

komisariat për mashtrim. Ku të mbytsha unë, me tërë ato para?! Vendosa të them të vërtetën.

- Jo, - i thashë. Amerikanen e marr vitnë tjatër. T'ju a tregoj shqiptaren?

- ç'ta shohim-o?! Kot-o? Kemi parë pe tyre, sa të dhjeç!

E vura re që ay nuku kish më asnjë çikë respekt për mua, siç kish kur bëri

pyetjen e parë.

- Afrohu, afrohu, - më tha kryepolica. - Ce i mban duart mbi tope-o? Të

ftohen, apo ke frikë ce mos t'i marrëm më sysh?

Tërë policat zunë të qeshnin. Mua, qellza m'u bë furrë e gjuha m'u poq.

- Hiç, ja ashtu kot, - ia bëra i mekur dhe m'u kujtuanë porositë e Rezit në

aroport të Kenedit: " Peço, mos i shpjerë duart atje!" Zotëria juaj, më falni!- u thashë.

- Po ç'zotëri o t'u mbylltë e mëndjes! vazhdovi skuadërkumandanti.Kujton

se si ato që ke ti, nuku ka njeri-o?! Nga ato të tuat, e më të mëdha bile, gjen me qindra këtej, ore! Apo kujton koka jote, se ike ti në mërgim e mbet Korça pa topemëdhenj!

Unë nuk i përgjigjsha fare, që mos e acaronja. Dhe skuadërkumandanti u tall sa u tall, më në fund na lëshovi të gjithëve të ngjitshim në autobuz.

U plasa në vend tem, dyke marrë frymë me zor. Po nuku paskëshin mbaruarë telashet. Autobuzi sa do nisej, kur te porta u dha një nga policat e më thirri gjene të xbrisnja:

- Të vijë pak ay amerikani!- urdhërovi.

Po më pushonte zemra. çfarë deshnë akoma pe meje, mor aman!

Dolla jashtë dhe njëherë. Aty pashë skuadërkumandantnë që seç po llafoste me

një policë kokëpaqethur. Desha t'u afrosha, por kumandanti ma bëri me shënjë të prisnja dhe ca. Polica kokëpaqethur seç po i tregonte ca gjëra në vesh e kur mbarovi, shefi i tij më ftovi me dy gishtrinj.

- Këtë polic e kam pe Opari, - më tha e më pyeti: Do zotrote që të hysh në

garë me të? Do ta provosh e ta dish se ç'vend ze ti, në qytetin tend? Po ta kalovi ky oparaku, për madhësinë e atyre, do t'i japç këtij oparakut njëqind dollarë!

Polica kokëpaqethur më ndiqte me sy mua dhe tundëte kokën për ato që thosh

kumandanti, i cili desh ta bënte këtë garën mashkullore, jozyrtare, ashtu sa më miqësore, si për mirseardhje.

- Ama, fitove ti, - më sigurovi kumandanti, - ky vartësi im do të të dorëzojë,

trëng, njëqind dollarë!

- Euro! saktësovi oparaku. Dhe u kthye direkt nga unë. - Euro, kam unë. Ta

kemi, pa nisur garën!

Dukej ca i trembur. I qe betuarë kumandantit, që nuku kish burrë t'ia kalonte atij, por tashi e kish humbur sigurinë, shëkonte i trëmbur në fund të barkut tim e i zverdhur dyllë përsëriste:

- Euro, kam! Laj-thaj, ato kam! M'i fitove, hallall i paç! e lëshonte djersë të ftohta, ngaqë ish bërë kot trim për këtë ballafaqim.

Edhe mua djersët çurkë po më vinin. Autobuzi priste për mua, mikrobuzi priste

për oparakun.

- Nuku jam përgatitur për këta lloj kampionatesh, - u thashë me njerëzillëk. "

Unë nuk u mbura me asgjë… që t'ju ofendonja juve! Bile, unë e pranoj garën të humbur! Dhe për nder tuaj, edhe për kënaqësinë teme, ja edhe 100 dollarët! Pijeni nga një kafe pe meje!

Dhe futa dorën në xhep, të nxirrnja dollarët. Më kishnë rrëfyerë për këto ndalime,

por nuk pata besuarë se t'i merrnin paratë dhe për kësi lloj sebepesh. Kumandanti nuku ma la ta nxirrnja dorën nga xhepi.

- Po bëre nga këto, do të të hedh hekurat! më kërcënovi. - Nuku duanë para

kot njerëzit e mij. Këta fitojnë vetëm para të nderçme, atë që e meritojnë, atë që e nxjerrën me.. me … djersë e me… ç't'u vijë! Po para të nderçme, ama!

Hipa prapë në autobuz, tani i çliruarë fare. Dëgjonja ankesat e policës pe Opari:

- Po si, or q..fjaj tëmën, nuk u bë një herë një garë e vërtetë, burrash! Të dalë e vërteta e pastër në shesh!

Kështu u këtheva në shtëpi… Sa u çmallmë e u përlotmë, unë vajta në dhomë,

zgjidha rripat e llastikat, hoqa xhumbën që aty ku ishte dhe u ndjeva i lehtësuarë.

Nisa t'i ndanja dollarët që atë ditë. Cilja që kish më shumë, erdh i mori i pari, dollarët e tij. Të tërë kishnë halle. Shumica ishnë pa punë. I vëllai i Zihni Pepellashit, priste para, ce kish vendosur të martohej e të bënte goxha dasmë.

- Po ja, punë nuku po gjej, më tha. - Kërkova një vizë për Greqi, s'ma

dhanë. Sa të rri kot! Po martohem, thashë… Të engledisem…

Nëna e Kocit të Mitropolisë mori paratë e të birt e shkovi drejt e në dyqan të

bukës, të shlyente borxhnë, se tërë muajnë e kish marrë bukën me listë.

Po më i lumuri isha unë. E ndjenja veten të lehtë dhe as femrat as policat nuk i hidhnin më sytë këtej nga mua…

* * *

Në këthim, ishmë gjashtë shqiptarë, në aroport të Vjenës, që të nesmen do

merrmim që andejza aropllanë për n'Amerikë. Që të gjashtë kishmë tentuarë të nxirrmim viza tek austriaku: nga një vizkë tranzit, bre, sa për të kaluarë cazë natën, sa për të mos u shtrirë, si lopët, dëpër stolat e sallave të pritjes. Mua në Tiranë, më thanë që te austriaku qe goxha procedurë e hante kohë. Kështu u patnë thënë disave pe nesh edhe në konsullatat austriake të Amerikës.

Siç ishmë të gjashtë, vamë e biseduamë edhe me Shefnë e Sigurimit të aroportit

të Vjenës. I thamë të na shpinin ata, në donjë hotel për të qenë, të shoqëruarë nga njerëzit e tyre. Po ishte sikur t'i flisnje murit, o t'i ..nje austriaken! Na tha, se ay nuku mund të gjykonte rregullat e

konsullatave e nuku bënte dot n'aroport punën, që bënin ato! Ay nuku vinte dot policat e tij të na ruanin, të na shpinin e sillnin, ce neve nuk ishmë të arrestuarë. Na tha se ne ishmë qytetarë të nderuarë të Evropës, ne tashi ishmë si gjithë Evropa e prandajza do të flimim aty dëpër stola..

U pamë sydërsy. Ky qe fati. Na iku lezeti i rrugës, lezeti i takimit me familjet. Ndryshe kur i dëgjon këto aventyra, bre, e ndryshe kur i provoke mbi lëkurë!

Po bëshim gati të kalomim natën me kafe e muhabet. Një burrë pe Durrësi na tha se ay kish qënë në Vjenë, vite më parë, por e mbante mend si tashi. E premtovi të na shpinte me llaf të gojës së tij, shesh më shesh e rrugë më rrugë… Do na e tregonte atë qytet fill e për pe, aq të gjallë, aq të gjallë, sa të mos thoshmim dot kurrë, se nuku kishmë qënë në kryeqytet të Austrisë!

Në atë mesele, fap, kumbisi e më zuri udhën Janka, bullgarka!

- Heeeej! ia bëri gjithë gaz ajo. Sa të kam kërkuarë!

Më prezantovi me tërë shokët e shoqet: bullgarë, kroatë, maqedonë.

- Do të dalim? më pyeti në fund, - të kujtohet si e lamë pllanë?

- Nuku mora dot vizë, i thashë. Pikë e vrer e me zë të mekur!

Asaj sëkur i ra dambllaja. Shokët s'po e kuptonin se ç'po ndodhte me të. Pastaj ajo xbriti sytë më poshtë, këtejza nga pantollonat e mia. Unë paratë nuk i kisha më aty ku m'i kish parë ajo dhe tani po e ndjenja veten akoma më të shburrëruarë. Pa **** pa viza! Lere, bre! A ka më keq?!

Vejushka tundi kokën hidhur. Dhe më la .

Shokët e shoqet, po e thërrisnin. Ishnë tre bullgarë, shtatë maqedonë dhe dy

kroatë. Ata po matshin të kalonin natën në një hotel buzë atij lumit, që rrjedh dëpër Vjenë. U drejtuanë nga porta dyke qeshur e dyke bërë zhurmë.

Te porta, Janka më tundi pëllëmbkën e saj të vockël me pikëllim dhe iku me ata

ballkanasit zhurmëmëdhenj, që pasi kaluanë para Shefit të Sigurimit të aroportit, - që as u bëri vërrejtje për shamatën, por përkundrazi i nderovi me "gatitu" - duallë rrugëve të kryeqytetit të muzikës.

Unë iu bashkova shqiptarëve të tjerë, të shtrirë dëpër stola dhe një

burrë fisnik pe Durrësi, nisi të na shëtiste dëpër Vjenë me rrëfimnë e tij…

Rrefenja e dhjetë: Presidenti i Amerikës apo guvernatori i Nebraskës?

Ne i themi shkurt, Papkë e unë nuk e kam marrë vesh kurrë, si i thonë gjatë. Është kushëri i gruas, një beqar i leshtë, po është rregulluarë mirë me shtëpi e me të tëra, ce ka ardhur në Amerikë, përpara meje. Sado kokunjur punon Papka, gjene skërfyell mbetet. Punon me mua, bile punonte atje më parë e unë pe atij e kam punën që bëj. Ay pe vitesh lan taksitë dhe limuzinat e bossit. Vjen i gjatë, si i ushqyerë tërë jetën me zorrë. Kur than xhamet me peshqirë e madh, nuku vete hiç në anën tjatër, po zgjatet mbi çatinë e taksisë dhe arrin matanë, pa pikën e mundit. Sa herë lan makinën time, unë bëj sëkur nuk e njoh e i jap nga donjë pesëdhjeçe, si bakshish, që të gënjehen e t'i japën edhe shoferët e tjerë, po ata s'bjenë që s'bjenë në çark! E Papka, në darkë, ma jep gjene pesëdhjeçen, që t'i jap pesë dollarë, aq sa meriton.

Bossi e do shumë Papkën e i vjen keq që nuku ka donjë çupë, që ta bëjë atë dhëndër, ce vajti dyzet e ca vjet i ziu e nuk e pret bishtin me donjërën, siç e kam prerë unë me kushërirën e tij.

E vjen sëra, ky Papka më bëri me punë. I pat thënë bossit, se ka një shok shofer, që e di anglishten. "E nget makinën me një dorë, më mirë se me të dyja!" - i pat thënë.

Atë reklamë dinte pyka, atë përdori e bossi më thirri. Vajçë. Më pa patentën e shtetit të Nju Jorkut, më kërkovi numërin social dhe pa që unë isha qelq i pastër.

- Mirë, - më tha bossi. Do kalosh në komision të provimit.

Më zuri tartakuti, sëkur më futi njeri dënë vete donjë nga ato stepinjtë e akullit.

Më hynë të dridhurat.

- Tani ta dua ndihmën, o shën Gjergj! ia bëra me vete.

Më ulnë përpara një kompiuteri dhe dy burra turivarur u ulnë matanë kurriz për kurriz, para kompiuterave të tyre, që i kishnë të lidhur me timin. Të mos isha vetë mbi gjemba, do ta shijonja më shumë këtë provim me kompiutera, që as në revistat e shkencës nuk e kishnja parë. "Është Amerikë këtu, o Peço, o tutkun! - i thashë vetes, - po përmblidhu, ce nuku gjen rast si ky e po humbe, do të shkosh në hale të gomarëve!" Ja kur mos i kem tërë, kështu i thashë. E Peçua, dyllë i verdhë, me gojë të tharë më tha: "Unë do bëj timen! Si të jetë e thënë, pastaj!"

Njëri pe atyre turivarurve, pa parë hiç këtej nga unë, më tha se në ekran do m'u shfaqkej pyetja, bashkë me katër përgjigje, pe të cilave vetëm njëra do ish e sakta. E unë me një miushkë, do lëviznja një shigjetkë e ta vinja klik, mu mbi përgjigjen e mirë.

- Fillojmë? - pyeti me zë të trashë ay tjetri, me një derro vëth në vesh.

- Fillojmë, - i thashë unë tri herë, ce në përpjekjen e tretë më dolli zëri.

Bamp! Se ç'bëri aty në ekran tem dhe më dolli kërkes e parë: "Sa bëjnë 50 heqim 40?" Dhe vap - vap - vap! - më duallë katër përgjigje të ndryshme. 20, 30, 90 dhe 10! Kjo përgjigje e fundit ish tamam siç e dimë ne, që në kohë të babaqemos! Po unë thashë, po të zgjidhnja këtë, do bënja donjë gabim. Amerika, dyqindvjet përpara të tërëve, do të më thënkej mua hajde o Peço, ce ta kemi shtruar sofrën! Kush i ha ato? Prandaj, përgjigjes së katërt nuku deshnja t'ia hidhnja sytë, se nuku kishnja qef të të bësha gazi i botës..

Mirëpo, hajde gjeje! E po kjo pikë e zezë?! Prisnja djersët, ato më erdhnë dhe ay me vëth u ngrit e më solli një letër, që t'i fshinja. Që aty kish një hile, këtë nuku ma hiqte njeri nga mëndja, se nuku do mblidhshin tre burra e tre kompiutera, për të bërë një pufkë, po cila ishte? "Hë mo Peço, mo bythkë, - iu zbraza edhe një herë vetes, - këtu të dua! Ce zotrote, në kohë tënde, ke qënë edhe nxënsi më i mirë i Raqi Qirinxhiut de! Hidhu tashi!"… Më kishnë folur shumë për këto lloj testesh, po tjatër është, bre, të të tregojnë për zjarrë e tjatër t'i kesh vetë duart deri në brylle në të.

Ata prisnin. Kjo nuku më prishte punë, ce kishnja dëgjuarë, që këta biçimër kanë respekt për ata që mendohen shumë.

- A mund ta ndez një duhan? pyeta prefesorët.

Ata u panë sydërsy dhe megjithqë aty nuku lejohej, mua ma dhanë lejën. Kjo më

bindi që edhe ata e kuptokshin, që zgjidhja nuk ish e kollajtë.

- A kini zjarr? i pyeta.

Njëri pe tyre nxorri çakmaknë e ma zgjati.

- Po cigare? e pyeta gjene i hutuarë, sa më s'bëhej.

Ay qeshi e ma dha edhe cigaren me bujari. Demek, atyre u pëlqekërke edhe kur e

ke humbur torruan.

Të jam menduarë, ore burr i dheut… Sa? Njëzet minuta, është pak!

Njëherë thashë, t'i këllas flamën, ta le këtë test, të ngre duart e të kërkoj donjë punë tjetër gjëkundi. Pastaj i dhashë karar: do zgjedh atë që dij unë, që pesëdhjetës po t'i heqëm dyzet, dhjetë do t'i mbeten! Ne andej nga Ballkani kështu e dijmë. Fundja, në e dinja gabim, ky nuk ishte vetëm turp i im, de! Ne jemi një komb i tërë, bashkë me trevat që kemi jashtë kufinjve, që e dimë kështu! Le ta hamë turpin, të gjithë sa jemi! Ce vetëm unë-a? Kur turpi pjesëtohet, nuk është më aq i rëndë. Me të menduarë kombin, më pushtovi një krenari, një krenari bre, që xheç m'u mbushnë sytë me lot. Kur je larg, je më atdhetar, ore! Kur mos kem fëmijët, xheç ia nisa hymnit! Goja ma mbajti.

Një të zënë mijushkën e kompiuterit me tërsëllëmë, sa xheç e theva siç thyhen kaçkat, një ta afruarë shigjetkën tek përgjigja e katërt e klik, ia bëra mbi të: 10! Dhjetë o dhjetë, në të sëmës të vinte puna si shofer, po të qe ndryshe! Dhjetë e nuk lëviz hiç, le të jetë përgjigje e vjetëruarë!

Të plasnë duartrokitjet e të fillovi një muzikë madhështore, me bandë! I bënte kompiuteri vetë, kur ti e gjenje pyetjen. Hajde muzikë hajde! Ore, të them, nuku pushonin duartrokitjet, sa xheç u ngrita më këmbë!

Ata dy të komisionit psherëtinë të lehtësuarë. Ajo paskësh qënë! E vjetra, e

babaqemos! Ata me buzë në gaz, u kthyenë e panë njëritjatrin.

Kjo fitore më dha zemër dhe pyetjen tjatër nuk e lashë të merrte firomë: " 70 përqind e njëqindës është: a) Më shumë se njëqind? b) Baraz me njëqind? c) Më pak se njëqind? apo, d) Shtatë herë më shumë se njëqind?.. Unë pështeta kokën te shkolla fillore e fshatit tem dhe, fap, e gjeta menjëherë: Duartrokitje të zgjatura. Muzikë me bandë dhe ata dy të komisionit, që nisnë të më shëkonin sëkur kishnë përpara Ajnshtajnë!

Pastaj nuku kishte më test, ce i vura përpara prefesorët! Në ekran më dolli pyetja se kush është më i lartë në gradë, Presidenti i Amerikës, Drejtori i shkollës së mesme, Guvernatori i Nebraskës apo menaxheri i një kompanie ajrore? E gjeta, pa vrarë shumë mendjen dhe e pashë që respekti i tyre për mua, kish marrë tashi ca të përpjeta që të merrnin mëndjen!

E kuptova: ata për shofer më deshnë, aq të ngritur më kërkonin! Pyetja e parë dhe e dyta deshnë që të provonin a dinja të bëj llogari e t'u këthej pasagjerëve kusuret tamam. E treta paskej qënë, që kur të përdornja limuzinën, mos ngatërronja personalitetet. Më bënë edhe një pyetkë se mos bënja donjë budallallëk e harxhonja më shumë benzinë nga ç'duhej: më thanë se cilën rrugë do zgjidhnja, për të

vajtur më shkurt nga Astoria gjer në Central Park?

- Në cilin pikë të Central Parkut? i pyeta kakapër, - dhe e doni me urë të

paguarë, apo me urë të papaguarë?

U pëlqevi kundrapyetja. Ulnë kokën të bindur për suksesnë tem e rrinin të nemitur. “Hë më ju hëngsha tëmat!” - thashë dhe ndjenja, që gjoksi po më fryhej si kacek pe krenarisë. Ata nxuarrë të shkruara përgjigjet teme nga kompiuteri, fësht e grisnë fletën e bramp, u ngritnë më këmbë. Hynë të dy në një derë dhe duallë që andej, tok me shefnë.

Shefi rrëzëllente. I qeshur më zgjati dorën dhe më përqafovi. Njëri nga ata solli një shampanjë dhe e hapi.

Më kishnë pranuar.

Më kishnë pranuar, po e di çfarë do të thoshte kjo për mua, apo jo? Ay me vëth solli një aparat e na nxorri tok me shefnë në fotografi. Pastaj më nxorri vetëm mua. I ndënja me ballë, i ndënja me faqe, vetëm profil, për policinë, siç mbanja mënd nga Greqia. Po këta s’e dashkërkshin profile. Bossi vajti dhe e mori Papkën e gjatë, që më priste, i ziu, jashtë me merak. E si duket ia kish thënë lajmnë e gëzuarë, ce Papka kur erdhi i kish sytë me lotë. U shkurtua nja gjysmë metro, që të më përqafte dhe xheç më mbyti me të puthura.

Kur duallmë jashtë në oborr, pashë tërë ato taksi e limuzina që prisnin e më shëmbëllenin si buallica, si qe dhe lope, të bardha e të zeza. Xhamet e tyre dukshin si sy të qeshur e më bëshe sëkur më thoshnë:

- Do punojmë bashkë, ëh Peço?..

_____

Rrëfenja e njëmbëdhjetë: Në pritje për një burrë amerikan

Tëmën e sëmës, sa e koklavitur është bota e fshehtë e dëshirave, ç'zjen aty brënda e ç'kapak u vihet përsipër!

Do rrëfej ca, për komshien tonë, Rozën.

Gruaja ime e ka shtuarë shoqërinë aq shumë me atë Rozë, sa më afër nuku afrohen dot e tashi nuk u mbetet veç të zihen nga leshrat.

Atë asëll-asëll e quajnë Lule, po ajo paskësh vendosur ta bëjë emrin më lule akoma, e bile më të përcaktuarë: zgjodhi trendafilë e tashi tërë ne, e thërresim Rozë! Nuk e di seç origjinë fetare ka patur familja e Rozës, por vajza këto kohë var në qafë një kryq aq të madh, sa tërë ne jemi të bindur që do të jetë myslimankë.

O Zoti Krisht, o zonja Shënmëri! - thotë një e dy, - sa mëkatarë që jemi!

Hamë mbushëm barkun e nuku na vjen turp nga të uriturit dëpër botë! Neve duhet ta kalojmë jetën më gjunjë, dyke u lutur për ata që bjenë pa ngrënë.

E më të shumën, këtë e thotë kur unë jam në bukë e sipër, pasi kam erdhur nga

puna. Ma ze në fyt o në ..çkë të sëmës! Kaq herë jam matur t'ia vërvit Rozës pjatën turinjve.

Banon pranë nesh, rrugica na ndan. Tarraca jonë e pasme, ku unë kujdesem për sistemnë e ajrimit, është rrafsh me dritaret e Rozës, që pe përtej rrugicës, shohën këtej. Ajo i mban ato hapur dhe unë përpiqem të mos i vërtit sytë andejza. Kur më sheh ajo, ma bën me dorë dhe më hedh që matanë donjë të fala për Rezin. Kur ajo nuk e ka mendjen e shoh unë. Ajo rri ashtu me kurriz nga rruga, dyke parë filma.

Filma po, por ama asnjëherë nuku e kam parë Rozën më gjunjë, dyke u lutur!

Roza punon si shoqëruese zonjash të vjetra. Ato e paguajnë dhe ajo i shoqëron ato në psonisje, në kisha, nëpër parqe. Nuk paguhet keq Roza, se ka një përvojë pe infermjerke dhe veç kësaj ka bërë edhe ca kurse specializimesh. Shihen plot diplloma të varura dëpër muret e apartamentit të saj pe beqarke. Plakat, më së shumti, i vdesën, megjithë përpjekjet e lutjet e Rozës që ato të jetojnë. Një damë e vjetër boshnjake jetovi në shoqëri të Rozës vetëm tri javë (nuk ia pamë kryqnë Rozës ato ditë!). Roza e qavi mjaft, ce ish grua e mirë e

jo vetëm ngaqë ajo e pat paguarë më mirë pe të gjithave. Pastaj, pas vdekjes së boshnjakes, çupa e nxori prapë kryqnë dhe e vari në gjoks.

E mirkë është Roza e lezeçme, po ama si ndonjë ëmbëlsirë e pazënë me dorë. Ime shoqe Rezarta, që i pret drutë shkurt, e këshillon të martohet, se po i ikën edhe vafti. Pas llogarive, Roza duhet ta mbajë mend prishjen e kishave në Shqipëri.

Të martohem me shqiptarë moj?! murrtërohet vajza, - Kurrë! Po më dolli donjë amerikan, do të mendohem. Po nuku dolli, do t'u përkushtohem lutjeve. Shqiptarët, m'i hiq nga defteri! Unë pe atyre, lashë Shqipërinë!

Po sëkur të të propozoj unë njëckë, moj Rozkë?

Cilin moj Rezkë? Shqiptar është, me?

Po sigurisht, me! Unë nuku njoh amerikanë. Është një kushëri i imi.

Rakinë s'ta pi, duhanë s'ta duron… Bixhozit, i thotë më marsh pleshtat…!

Keq më vjen për një njeri kaq të mirë. E do të lutem për të, se qënka shenjt.

Bile, habitem se si na qënkësh edhe shenjt edhe shqiptar?!! çudi!

Vuri duart e bashkuara në ballë e nisi të lutej vërtet.

E durova. Më vjen keq për të zezën. Nuk i mbaj inat.

Unë vete i bëj donjë riparim. I shoh nga njëherë kutinë e kabllit që e ka të vjetër.

Dhe komshia jonë është aq beqare dhe e vetmuarë, sa marr dhe Rezin me vete, kur kam për t'i ndrequr galexhanë, për t'i zhbllokuarë tubnë e vaskës, a për t'i fokusuarë kanalet që shfaqën meshat fetare, për të cilët Roza na qahet çdo ditë se nuku para i dalin qartë dhe mirë.

Një natë, verë paska qenë, sistemi i ftohjes na hodhi vickëla dhe unë dolla në tarracë, t'i ipnja një të shkundur. Hedh sytë pa dashur nga dritarja e Rozës dhe nuku deshnja t'u besonja: Roza kish qëndruarë si çdo mbrëmje para televizorit, kish pështjellë gjunjët me krahë dhe dukej e përhumbur në kanalin 35, në atë kanal ku femrat e meshkujt dalën lakuriq e përkëdhelën njeri-tjatrin.

Thash njëherë të shkoj të marr time shoqe, por pastaj i thashë vetes: përse?! Përse o Peçi, o derëzi, t'i tregosh Rezartës ca anë të fshehta të shoqes së saj, që ajo nuku duhet t'i dijë e nuku do t'i dinje as ti, o Peçkë, sëkur Roza të mos kish harruarë perdet e hapura!!!

Vazhdova të punonja me sistemnë e ftohjes pa i hedhur më sytë as

edhe një çast nga dritarja e Rozës. Mbarova dhe ika me kokën e futur thellë mes supeve. Kur nxora kyçnë, që të mbyllnja derën e tarracës, që asnjë të mos vinte e ta zinte Rozkën tonë dyke soditur pornot, thashë ta shoh se mos, desh Zoti, Roza e kish kaluarë më donjë tjatër kanal. Po ç'neee! Roza me kumandën e telvizorit në dorë, ia kish mbërthyerë sytë një zezaku lakuriq, që përpiqej të flinte në të njëjtin krevat me dy të bardha njëherësh.

Nuku e mbylla hiç derën e tarracës. Xbrita me ngut deri në apartment tem dhe mora kumandën e kutisë të kanaleve, që e kishmë njësoj si kumandën e Rozës. I vura dy bateri, fringo të reja dhe provova ta kumandonja kutinë tonë njëherë, që pe fundit të dhomës së gjumit. Kumanda kish fuqi dhe kutia u bindej urdhërave që larg. U ngjita në tarracë dhe iu afrova buzës së saj, që nga kisha shpresë që kumanda të arrinte të ndërronte dhe kanalet e Rozës. Larg ishin për të qenë, po thashë ta shtyp njëherë, mbase arrinja t'ia ndërronja që atje.

E shtypa kumandën në një kanal që jepte jetën e përdëllyerë të shënjtorëve. Figura e shënjtorit dolli. Roza sefte nuku e kuptovi se si në televizor të saj, zezaku hamshor iu bë shenjtor! Nuk po jepte shënja lëvizje. Unë kujtova se çupën e kish zënë gjumi, por jooo! Roza ngriti me ashk kumandën që kish në dorë, ia drejtovi ekranit si atentatorët e guerrileve dhe tak, e shpuri te zezaku që u shërbente atyre dy bjondeve. Edhe Rozës iu bind kumanda e saj. Por ama m'u bind edhe mua ce unë gjene ia shpura te shënjtorët! Ajo te hamshorët, unë te shënjtorët! Ajo atje, unë këtu! Nuku kish të mbaruarë ky dyluftim e kjo punë!

U dorëzova dhe e lashë Rozën të kulloste sytë. Bëra të ik, por aty më vajti dërmend t'i shfaqnja Rozës një gjellë tjatër. Kërkova në errësirë numërat dhe gjeta me telekumandën time pamjet e një meshe të shumëpritur, në Katedrale të Shën Patrikut në Aveny të Pestë. Kori i famshmë i katedrales, po ekzekutonte diçka të madhërishme. Në ekran shfaqshin gra të përlotura dhe ca murale që shpjemë o zot t'i shëkoj!

Por Roza më kundërshtovi gjene dhe m'i hoqi edhe ato pamje. Ajo nuk desh t'i ndahej kanalit porno oreee, dhe unë pashë-ç'pashë, u fërshëlleva ëngjëjve të mi të më ndiqnin pas dhe e lashë Rozën me djajtë e saj.

Kur u këtheva nga puna të nesmen, e gjeta Rozkën dyke i treguarë zonjës sime se ç'meshë madhështore qe bërë mbrëmë në Shën Patrik. Ia përshkruante Rezartës me tërë bukuritë e korit, faqet e lagura nga lotët dhe muralet gjeniale (që të qe për Rozën, nuk i ndërronte as me gishtnë e këmbës të zezakut!… Po ama unë e ajo e dimim këtë!)

Roza e la një çast tregimnë dhe m'u drejtua mua:

Ore Peço, ay televizori ka filluar e nuk m'i mban kanalet. Dua për shëmbull unë të shoh një meshë: nuku më qëndron atje.

Mos e shtyp kumandën pa dashur, ti moj Rozkë!

Po ç'ne-o! Unë e le te mesha, figura më ik! Do vish të ma shohç një çikë?

Do të vijmë, moj do të vijmë. Ja thuaja Rezit, të ma kujtojë.

Unë po shpinja pjatat në të ndarën e guzhinës, kur Roza i dha gruas sime një lajm befasues.

E di se ç'më ndodh mua Rezi? Do të ta dëftej, po ama, unë e ti, ëh! Se është nga Ay, i Madhi atje lart!

ç'është me korbë?! dhe zonja ime afrovi kokën, aq sa sekretet e kanë lehtë të kalojnë urën Gojëvesh Brixh.

Kohët e fundit më qëllon të shoh, përshëmbëll, filma, a donjë rrëshqitje mbi akull, - nisi t'i pëshpëritë Roza sekretnë. Kur, fap (!), si me urdhër pe lart, më ndërrohet figura vetë. Ja, kur mos i kem tërë! Më faniten shënjtorë, apostuj, ëngjëj të parajsës, mesha të hyjnuara religjoze. Kushedi se ç'kumt do të jetë ky, ëh?! Ec e lexoi kumtet po munde?!

Me bisht të syrit pashë time shoqe që çapëlovi sytë e gojën tok. Kur shkuamë në krevat, ajo ma tha me një fshehtësi të madhërishme, se si nga lutjet e përdëllyera që bënte me orë të tëra para Shën Mërisë, Rozës paskëshin filluarë t'i shfaqshin vegime qiellore..

Do të jetë donjë kumt ky, Peço? Unë e kuptoj kumtin: ay thotë që ajo femër

është paracaktuarë nga i Gjithëfuqishmi që të bëhet shënjte!

Kush-me, Roza?!

Eh Roza!

Shënjte?!

E-e, shënjte! Ja ti Peço, si thua?

Unë e lexoj ndryshe kumtin, - i thashë. - I Gjithëfuqishmi i dërgon Rozës këshilla që të martohet sa më parë, ce kush e duron!.. Le të marrë daç shqiptar daç senegalez, po vetëm të martohet!…

Rrëfenja e dymbëdhjetë: çlirimi i Nju Jorkut nga gjermanët

Unë e shpie Xha Jazon për ditë në kafenetë e Arthur Avenysë. Tëmën!.. Nuk e kam kuptuarë kurrë ce njerëzit nuku i duanë hiç të sklerozuarit. Mua më mbërthejnë historitë e çaprashitura të xha Jazos, që ka bërë një jetë aq larushe. Kujtesa e tij, si donjë dhi e egër harbon në të gjitha skërkat e pllajat e jetës së plakut: partizan, oficer në ushtri, kryetar kooperative, i deklasuar... Harbon dhia harbon, por gjene te pllaja e partizanit vete qëndron. Vërtet dolli malit ditëve të fundit, por ay partizan ka qef të mbahet mend! Me që i biri, bëri atë gjëmën me arratisjen e tij nga Saranda, me not, Jazon e hoqnë pe kreut të kooperativës, e përzunë pe organizatës së komunistëve e pastaj e syrgjynosnë me gjithë familje në një fshat të Gorës.

Tashi në Shqipëri është një kohë, kur tërë mundohen të gjejnë një gërvishje nga diktatura. Jazua e ka brazdën të gjakosur e i kthen kurrizë! Vete e lidhet pas të dalurit në mal! Tëmën, se ç'mban mbi kurriz ky rruzull!

Tashi, me të birë,. atë të arratisurin, janë mbledhur bashkë. Xha Jazos i pëlqen Nju Jorku, ujrat që e çajnë dhe përndajnë qytetnë, pleksja e metrove, rekllamat e stërmëdha. I duken të bukura dhe shpesh në bisedat e tij e fut përvojën e re në kukumalen e madhe të asaj të vjetrës, ashtu siç futet në një libër me shumë fletë, një fashikull tjetër, që nuku ka të bëjë hiç me atë libër.

Në rrëfenjat e tij Xha Jazua nuku gënjen. Skleroza nuk e njeh gënjeshtrën dhe bile ajo nuku ka fare nevojë për të. Xha Jazua thjesht rrëfen ngjarje që edhe mund të ndodhnin. Rradha e kohëve i është kokolepsur, por plaku nuk e vret mëndjen t'i shpleksë e t'i rreshtojë.

Ka një urrejtje të pashuarë kundra gjermanëve. Një ditë më tha se Amerika duhet t'ia dinte për nder brigadës së tij, që arrivi të mos mbetej këtu në Nju Jork këmbë gjermani. Më thëthivi mjaft me këtë thënie dhe unë e afrova karrekllën.

Po pinim kafe në trotuaret e Arthur Avenysë. Pa arritur ta pyes, xha Jazua u kurdis.

Po me t'i qërruarë gjermanët nga viset tona, i ndoqmë tutje. Brigata jonë, sikur qe bërë vetëm për gjuhetinë e tyre. Nxirri që këtu, qërroi që atje e bjeru prapa. Kur dëgjonin Brigatën e 55, ata i zinte tartakuti.

Unë nuku di të ketë patur brigadë me atë numër, por kjo është nga lajthitjet më të padëmshme të plakut!.

Më dyzetepesën, ishnë mbledhur tërë gjermanët nga ishnë e nga s'ishnë, në Gjermani. Që atje nuk kishmë pse t'i lonim, se ata ishnë futur në vathë të tyre. Pyet andej e pyet këtej: "More na thoni në ç'vend të botës ka akoma gjermanë, t'u sulemi e t'u vemë drunë?" Hiç! S'vinin ankesa. Kur, na thanë: kanë mbetur ca në Nju Jork. Do të vemë, thamë, do vemë e t'i qërrojmë edhe pe andej! U mblodh edhe një herë brigata. O burra, thamë, dhe u nismë! E tërë brigada!

Loj bre xha Jazo, vendit! Po si u futët në Amerikë? - nuk më ndënji goja mua.

E do të vërtetën? më tha. - Me viza fallco! E tërë brigata! Me pushkë e mitrolozë, me tërë armatimnë! Vimë në aroport të Kenedit. Atje kishnë ca nga këta aparatet, që të kontrollonin dëpër xhepa, për thika, për droga, për armë. Ishnë djegur këta të zestë, pe 11 shtatorit.

Mua gjene nuku m'u ndënj:

Edhe Njëmbëdhjetë Shtatori u fut këtu-o?!.. Po si nuku ju a zunë armët-o?

Neve i mbamim lart, bre, me të dy duart mbi kokë, se ata dëpër trup kontrollonin.

Aty nuk kishmë asgjë neve. Kaluamë të tërë. Asnjë batalon nuku na mbajtnë.Vimë neve, që thua ti, e të përhapemi atë natë dëpër këto kodrat rreth Nju Jorkut. E ndezmë zjarret tona. Llapsnin atë natë zjarret partizane, ca në Qafë Kuins, ca në korrijet e Stejtën Ajlandit, ca në meratë e Bronksit e ca mbi stanet e Nju Xhërsit. Batalonit të fundit nuk i kishnë ardhur mortajat. Ishnë ngatërruar kur ndrruamë oropllanë në Zyrih. Por, Svisseri, - për shërbim që bëjnë, t'u pish dollinë o në p.. të sëmës !, - u a solli mortajat të paprekura, po atë natë me mikrobuse! Të fundit i pamë zjarret e tyre në pllajat e Bruklinit. E kishmë rrethuarë Nju Jorknë e gjermanët shëkonin zjarret tona e me siguri po i zinte data. Po ama, neve nuk e dimë hiç ku janë strukur. Gjatë natës erdhnë dhe informatat e sakta: në Nju Jork, thanë, nuk ka aq gjermanë sa të nderohemi. Kanë mbetur vetëm nja tridhjetë a dyzet, në Avenynë të Parë, në konsullatët gjermane. Erdhmë që erdhmë, thamë, le t'u futim tmerrë dhe atyre dhe le të thyejnë qafën në Gjermani!.. Të nesmen, me formacion luftimi, me pesë kollona, mësymë Manhattanë! Drejt e në konsullatët gjermane!

Me se shkuatë-o?

Me sabuej-o, me metro. Itendenti na preu ca metrokarda dhe o burra! Neve muarmë trenë B! Në vagon buçisnin këngët partizane ore!.. Kur mo i kem tërë, të kishe qënë atje, nuku do mbaje mend gjë tjatër në jetë tënde! Me "ato maja rripa-rripa", me "kuq ësht ku lind e ku perëndon"…

Paaa! Nuk bezdisshin amerikanët-o? e çpova plaknë.

Jooo, ç'ne! Itendenti jonë i kish marrë masat, oree: sejcili pe neve kish kufjet e tij në veshë e neve dëgjonim në to: "ato maja… seç gjëmojnë". Amerikanët, ca studentë, ca zezakë, ca filipinas që shisnin bateri dëpër vagona, tërë ishin me kufjet e tyre. I tërë vagoni ish me kufje dhe pasagjerët tundçin nga ritmi. Po ashtu tundçin edhe ca partizanë nga tonët, ca të rinj, ca çunakë të pabindur. Ata me siguri kishnë vënë fshehur donjë këngë të Irma Libohovës. Se me "ato majat e rripa-rripat" nuk tundesh dot de! Dukej bre, nuku qe ay ritëm! E nejse… Vemë në konsullatë të gjermanëve. Rradhë e madhe atje bre: ca për viza, ca për martesa. Zumë rradhë edhe neve, ç'të bënim?! U zgjat rradha si mos o Zot! Kur erdhi sëra jonë, del një gjerman aty e na pyeti ce ishmë munduarë. "Kemi ardhur të çlirojmë Nju Jorknë", - i thamë. "Nga se?"- pyeti. "Nga ju, gjermanët!" ia thamë copë. Kur i treguamë se ishmë Brigata e 55, ay u bë dyllë i verdhë. Ashtu dyke iu dredhur zëri na tha se duhet të mbushmim një formular e t'i bashkëngjitmim me kapce dy fotografi të brigatës. "Po më parë", tha, "duhet të dorëzoni armët. Është rregull!". Veç njerëzit e egër nuku binden. I dorëzuamë ç'të bëmim?!. Nuku bëhej shaka me gjermanë! Nëne, nëne! Mbushmë formularë. Ne patmë çliruarë gjithata qytete, po me formular, jooo, nuku na kish bërë vaki t'i thyemim gjermanët. E mbushmë formularë, vumë dy fotografitë grup. Na thanë që kjo punë do të bëhet, por jo pa kaluarë 15 ditë. Ashtu ish rregulli. "Rregullin e respektojmë", u thamë dhe ikmë. Detyrën e kryemë…

Po armët? - ia kujtova unë.

- Me armët na ndezi groshi, se ata nuku na i jepnin prapë e ne i lamë. Kumandanti i brigadës desh të na proçedonte për gjyq ushtarak, por pastaj erdh lajmi që edhe në Shqipëri, depot e armëve ishnë shkallmuarë, ushtria qe bërë lesheli, piramidat kishnë thyerë qafën e qënkësh formuarë Qeveria e Pajtimit Kombëtar e në atë valë, na zuri dhe neve amnistia.

Mua nisnë të më merrçin mëntë: partizanë, piramida, amnistirat… Po e mblodha shpejt tutkën.

Po e çliruatë vërtet Nju Jorknë nga gjermanët? Dua të them, xha Jazo, a iknë ata pas pesëmbëdhjetë ditësh, siç ju thanë?

Duhet të kenë ikur. As mos e bëj dëm pyetkën! Gjermani qen bir qeni është, po fjalën e mban! Unë s'pata kohë ta marr vesh ce më binte bretku 14 orë në ditët, në punë të zezë. Një dibran më futi në restorant të tij, laja pjata. Pa karta. Dibrani paskësh qënë me Ballë, po paskësh qëlluarë burrë i mirë. Sefte flinja në shtëpi të tij. I kënaqur unë, i kënaqur dhe ballisti, ce e quante fitore të frymës së Mukjes…

Po ce nuk u këthyetë prapë në atdhe, pasi kryetë detyrën-o?

Ce-o, budallenj ishmë ne-o?!- ma bëri. - Qefi, or bir, ma kish të këthesha, po për ideal, xha Jazon e ke trokë. Si do të vija prapë në Amerikë unë? Ku kisha, bre, unë 13 mijë dollarë, të kërkonja prapë pashaportë fallco, apo të bridhnja dëpër skafe?! Pasaj, ja vjen e t'i bije skafit, donjë hundë motovedete italane! Unë nuk di as not or'i hëngsha tëmën!.. Kryesorja është që detyrën e kryemë.

E kryetë në Nju Jork, po në Shqipëri ke akoma gjermanë!

Po çne-o, ne e lamë vatanë pa këmbë gjermani!..

Ju e latë, - i thashë, - po atje ka akoma. Janë në ambasadën gjermane në Tiranë. Pastaj, ca të tjerë kanë erdhur si specialistë… Turistë varda…

Ne e lamë Shqipërinë, kur i thonë, gjerman-frii! Brigata të tjera atje ka. Sytë t'u dalën e le t'i nxjerrën ato! Ce o, nga Pestepesa i presën të gjitha-o?! Lodrat të politikës-mo, të këtyre qeveritarëve të soçmë. Këta i kanë tradhëtuarë idealet e luftës!- tha me mllef dyke pështyrë përdhe.

Pyetjet teme nuku kishnë fund. Më kënaqte xha Jazua me shashërditë e tij!

Qëndruatë në Shtetet e Bashkuara, si brigadë?

Pas fitores, u mblodhmë në Central Park, të gjithë batalonet, prapavija, ndërlidhja… Na foli komisari. Na përgëzovi për fitoren dhe na tha se, si shpërblim, shtabi kish vendosur që të na jepnin nga dhjetë vjet lejë, të pushomim, të gjemim këtu donjë të afërm, nga kurbetlinjtë e vjetër e të rinj. Ay, bile, na ftovi që të aplikomim për llotari grin kard. Tetë batalone i mbushnë aplikimet, kurse një batalon, i gjashti, kërkovi i tëri strehim politik. Ata e qelpnë fare! Kumandanti i tyre më vonë u shpall armik, me ata të kastës. Dukej, ajo! I tillë ishte qeni. U dënua me vdekje në mungesë. Tashi shëtit këtu me limuzinë, bën biznes me Shqipërinë, vete atje, ha dreka e darka me Nanon e nuku guxon qeni t'i rrëfejë Nanos se ç'dënim i rri mbi kokë. Nanua po, s'ka kohë të hapë qitapet e vjetra!… Neve këtu vazhdojmë e mblidhemi dëpër përvjetorë, festojmë… Donjëherë NY Fire Departmenti, i zjarrfiksave, na jep lejë të ndezim donjë zjarr dhe na gjobit kur e ndezëm të madh. Neve tashi i bëjmë zjarret gjithnjë të veckël e më të veckël, bëjmë shuk tri katër gazeta Nju Jork Tajms bashkë, sa për të bërë adetnë, kujtojmë kohët e arta, ndezëm donjë Marllboro dhe e thëthijmë nga njëzë herë e ia kalojmë shokut, me rradhë, si njëherë e një kohë, çmallemi, shkojmë të organizuarë në kazinotë e Atllantik Sitit…

E kështu rrjedh jetaaaa or biiir!….

Rrëfenja e trembëdhjetë: Hije në Filadelfia

Një xhaxhaj i sime shoqe, arratisur më pesëdhjetenjënë, kish humbur dëpër Amerikë, si gjilpëra në kashtë.

- Këtu duhet të jetë , - ngulte këmbë Rezi. - Ama e gjetmë, ia hodhmë fukarallëkut, se ay është i krimbur në para. Nuk është martuar kurrë! E na takon: pak vojtmë ne pe arratisjes së tij?!

Vazhdova ta kërkoj po aha, gjëndej Xhipja!

Po duhet të vijë dita, ore! Erdhi, e gjeta. Më telefonuanë nga kompania teme, Ist River Taksi end Limuzins:

- Bëj gati taksinë - më thanë, - dhe nesër do rrish tërë ditën andej nga Pensilvenia. Të caktuam ty, me që je shqiptar.

Zoti Bexhet, që desh taksinë, na kryesokej dhe ai një parti fringo të re, në Tiranë.

Amerikën e shkelte për herë të parë dhe desh para, ce financat i kish trokë. Vite të shkuara, mysafiri paskej qënë mësues marksizmi në një shkollë të mesme. Rrugës ay më thosh se kjo e kish bërë që të ishte antikomunist i prerë, ce komunizmën kish patur rast ta njihte që brënda.

Vizitën e parë e bëri te një nga antikomunistët më të thekur të këtejshmë, që banonte në Filadelfia, që kur qe arratisur nga mëmëdheu më ‘44. Që atë kohë Emin Brahimllari pat formuarë këtu në mërgim, një qeveri hije, si i thonë dhe e pat pritur rënien e Hoxhës, siç pret fukaraj beharë.

Plaku banonte në një shtëpi të bukur, me dy kate, në majë të së cilës valonte flamuri shqiptar, që mezi i dallohej shqiponja, ngaqë e kuqja kish marrë një të nxirë të përgjithëshme..

Portën na e hapi gruaja e Eminit, një turkeshë, shumë më e re se i shoqi. Dukej si donjë yll Hollivudi, veçse i kish korrur vetullat më të dy anët e i kish lënë ato vetëm sa dy vazhda të hequra me stillolaps. Gruaja na shpuri drejt e në dhomë të madhe, ku priste plaku, që siç ia desh sëra një kryetari qeverie, paçka në mërgim, nuku na e dha dorën hiç, por na shëkonte të dyve me mosbesim, që prapa gjyslykëve. “Tëmën, po unë bre, ç’dua këtu?” pyeta veten kur erdhi rradha e gjyslykët e plakut u vërtitnë mbi mua.

Shikimnë e plakut e kisha akoma mbi vete, kur u hap dera e një burrë tjatër, hyri brënda. Edhe ky, pa na dhënë dorën, vajt e ul pranë zotit Emin.

- Prapë autobuzi! Na u prish. Pritmë sa na dërguanë një tjatër. - i pështpështi plakut i porsaerdhuri, para se ky ta prezantonte

Kisha thirrur edhe ministra të tjerë, - na tha i zoti i shtëpisë, - po janë dëpër

punëra e nuku muarë dot lejë. Zotëria këtu me mua është Nexhip Sekseri, nga Gollokamja e Korçës.

Xheç kërceva përpjetë. Ky na ish Xhipja, xhaxhai i Rezit. Sa e kisha kërkuarë

këtë njeri! Xhipja, larg pe fotografive, vinte i dobët, sëkur vuante nga stomaku e leshkat i kishnë lënë shëndenë.

Bexheti nisi të bënte njohjet e mua më paraqiti si kryetar të degës së partisë së tij në Nju Jork, që gjoja nëmëronte gjer tashi katërqind antarë. Po unë mëndjen e kisha gjetkë dhe po dridhsha i tëri.

Jam, - iu drejtova më shumë Xhipes se të zot të shtëpisë, - i shoqi i Rezartës,

mbesës së zotërisë suaj. Dhe po bësha gati të ngrisha më këmbë që të hidhshim me Xhipen në krah të njërit tjetrit. Xhipes nuk i lëvizi qimja.

A kini një vëlla në Gollokamje? e pyeta mëdysh.

Po, - i a bëri Xhipja si i hutuarë për këtë të papritur.

- Të bijën e tij, e kam unë grua!

E gjene i bëra këmbët susta, që t'i vërsulsha në gjoks e të qamim një copë herë.

Ëhë, - ia bëri Xhipja dhe e hodhi njërën këmbë mbi tjetrën.

Edhe të tjerët aty, mbetnë ca si ngushtë, nga që Xhipja dukej sëkur nuku do të

lëvizte as po t'i qe ngjallur e jëma. Bexheti i Tiranës e prishi heshtjen dhe i pyeti zotërinjtë, ashtu kot, në kishnë dërmend të dilnin një vizitë asaj Shqipërie.

Të çlirohet nga zgjedha komuniste njëherë! ia bënë me një gojë Emini

me Xhipen.

Një tjatër në vend të Bexhetit do t'u thosh që tashi antikomunistët e shquarë,

hynin e dilnin në mëmëdhe. Por mysafiri pe Tirane nuku desh ta linte shtegnë që i dolli përpara e hyri drejt e në thela.

Mbase, - tha, - kur të vijë në pushtet partia ime, që me komunistët i ndan një

oqean! Për pushtetnë po lëftojmë, po për këtë na lipset ndihma juaj e çdo lloji qoftë ajo, që nga ajo më e madhja, moralja, gjer te ajo më e vogla, financiarja!

Unë shëkonja Xhipen dhe me gojë të hidhur, habitsha si dëgjonte me aq kujdes fjalët e mysafirit dhe si nuku po i hidhte sytë asnjëherë këtejza, nga burri i mbesës.

Bexheti ia la llafnë Eminit.

Ta nisim nga ndihma që kërkoni, - tha ky, - nga ajo më e parëndësishmja, siç

the zotrote: paratë. Mos prisni asnjë kacidhe! Ne jemi të shkundur. Gazeta jonë ka 32 vjet që nuku del më. Ministrave të mij, tërë atdhetarë të orës së parë, u bje bretku. Të moshuarë, të gjorët, punojnë akoma në ndërtime e pastrime. Koha vajti e gjatë e na këputi. Nuku gjen asnjë qeveri hije, që të ketë duruarë kaqe gjatë. Shtatë ministra hije më kanë vdekur gjer tashi. Edhe ky hija që kam këtu, - e tregovi Xhipen.- punët ministrore, kur i jep lejë një çunak menaxher, i bën me autobus.

Atëças turkesha hyri kokunjur e në një tabaka i solli të shoqt një qelq me ujë dhe një kokër hapje, që ta pinte, ce, si dukej, plaku kish orarë.

Viagra! më pështyu në vesh zëunjur Bexheti. Është nga ato që pi unë, të

shtunave të fundit të muajit. Kushtojnë shumë të bekuarat… Ky e pi në syt'tonë, që të na dëftejë se është akoma gjallë.

Kështu që na mbetet t'ju japëm, - vazhdovi plaku, - vetëm pështetje morale. U

bën punë?

Si drita e diellit! - ia kthevi Bexheti dhe unë ndjeva si iu tha, të gjorit, gjuha në

gojë, ce me siguri kuotat e tërë partisë, nuk i dilnin as për paratë e taksisë.

Atë do t'ju a japëm! vendosi plaku dhe pa nga Xhipja im, i cili vetëm

tundi kokën, siç bëjnë ministrat kur miratojnë buxhetet. Thashë se mikut pe Tirane do t'i binte të fikët, po nuk i ra. Po më parë, - tha kryetari i qeverisë, - kemi ca pyetka… Ini lidhur me këto partitë e

tjera shqiptare këtu, në Amerikë?

Jo, - u mbllaçit Bexheti e gënjente si derri.

Se duhet ta dini që me to, qeverinë time, e ndan thika! T'i kemi të qërruara

hesapet! Po vetë juve, kini qënë gjë në partinë e Enverit?

Jooooo! çne! ia pritmë me një gojë Bexheti që gënjente e unë që

s'gënjenja.

Bile, ky Peçua, ka bërë edhe burg, - vazhdovi Bexheti dhe m'u afrua mua,

që pa pritur i dolla më i vlefshmë si i burgosur, se shofer. Unë fryva gjoksnë me krenari, dyke vështuarë xhaxhanë e zonjës time drejt e në ninëz të syrit.

Dy burrat lanë Bexhetnë dhe m'u kthyenë mua.

Ti përse e hëngre burgun? ç'arrite t'u bësh komunistave? më pyeti hija më e

lartë dhe u gëlltit për ta shtyrë më tatëpjetë tabletkën që pivi.

Asgjë! i thashë me krenari.

Donjë sabotim-a, donjë atentat-a? pyeti xhaxhai i Rezit me shpresë.

Ncë, ncë, ncë! ia këtheva akoma krenar. Asgjë! Më burgosnë kot!

Dhe nuku po e kuptonja, hajvani, që po i bënja varrë vetes. Që të tre tani u

kthyenë e po më shëkonin me përbuzje e inat tok. Tëmën o dë … çkë të sëmës! I lanë të tëra e po më bënin gjyqnë mua, këtu dë mes të Amerikës! Të më hipi një i kuq nga turpi, që s'e donja veten. Nga të tërë aty, unë kishnja të kaluarën më të ndohtur: edhe nga Profesori i Marksizmit edhe nga xhaxhai i gruas edhe nga ky kryeministri, që pe 50 vjetësh, s'e lëvizte ****ën nga Filadelfia.

U betova që nuku do e zinja më kurrë në gojë burgun, faqen më të zezë të historisë time!

Këtë, - i tha për mua kryeministri hije Bexhetit, - nuku dua ta shoh më këtu!

Dhe u ngit më këmbë për të na përcjellë. Nuku ma dha dorën hiç. Ama, të them të

drejtën, unë e kisha kuptuarë që nuk e meritonja. Ula kokën dhe dolla jashtë pas Bexhetit.

Te vetura e vura re, që xhaxhanë e Rezit e kishmë prapa. Ay

përqafovi Profesorë e Marksizmit, kurse mua më zgjati si me neveri, që mos më takonte gishtrinjtë, një pecetkë pe letre, ku kish shënuarë adresën e tij.

Kjo është për Rezin, - më tha. Për time mbesë. Të më kërkojë në bodrum të

këtij billdingu. Po sakën se vjen tok me ty! Ti, të mos ma shëkosh derën!

U nismë. Nga pasqyrka pashë e dhe për ca kohë ministrin e asaj qeverisë, që

priste akoma të çlirohej Shqipëria. Ay rrinte buzë rrugës për donjë autobus, që ta shpinte në rezidencën e tij, në bodrumnë e atij pallatit që thosh adresa në xhep tem. Kurse bri meje, turivaruri Profesor i Marksizmit nuku më fliste, sëkur tërë takimnë ia kisha dhjerë unë, me burgun e sidomos që e kishnja bërë pa faj!..

* * *

Xha Emini kish vdekur po atë ditë, do një orë pasi kish pirë viagrën.Unë e Rezarta pritmë sa e varrosnë dhe ia mbajtmë për Filadelfia. Gjetmë adresën, gjetmë edhe shkallët që xbrisnin në bodrum të pallatit. Vetë unë, u fsheha dhe lashë time shoqe të xbriste dhe ca e të trokiste te dera e xhaxha Xhipes.

Kush është? u dëgjua zëri i Xhipes që brënda.

Jam Rezarta, xhaxha. Mbesa, çupa e tët vëllaj, Qazkës.

U bë një heshtje, pastajza u dëgjua zëri i natosur i Xhipes:

Juve ini të tërë komunista! Qërromu nga porta!

Rezin e zu të qarët.

Po ç'thua kështu o xhaxha?! Hape një herë të të ze për qafe e mos më

tako më, ce nuku dua asgjë pe teje. - Ajo zuri të fërkonte derën e lotët nisën t'i kullonin çurkë. - Hape, të… të ndahemi.

Nuku e kishnja parë time shoqe të qante ashtu dhe e kuptova që kjo e qarë ish ndryshe. Nuk ish për atë shpresën, se mos me të takuarë Xhipen punët tona këtu, do na vinin më mirë. Jo, jo ish tjatër gjë. Ish një humbje e tmerrshme bre, që atëças nuk e përcaktonja dot. Gruaja m'u plas para portës të një njeriu që më parë as i dhimbte hiç dhe tani po e gjente, jo hije, po të vdekur fare. Me një kotkë në fyt, nxitova ta ngrinja ce e kishnë përmbytur lotët.

Qërrohuni! ulërinte xhaxhaj që ish larg nga ne saç është e trashë dërrasa

e derës. Tërë komunista jeni! Ti e im vëlla, jot ëmë e gjithë të tjerët!.. Të internuarë, të burgosur, të vojtur a të lumtur: jeni tërë komunista!

Ata që e dinë sa mban Filadelfia nga Nju Jorku e kuptojnë më mirë sa zgjati e qara e Rezartës sime të gjorë.

Në shtëpi atë natë u bëra tapë me raki, si kurrë donjëherë në jetën teme. Mbaj mënd që me gojën shafran, këpusnja gjepura.

Ti je grua hije, - i thosha Rezit. Ti je mbesë hije e xhaxhajt hije… Kur

dielli është i shëmtuarë si ky, ç'pret nga juve, hijet!…

Table of Contents

Rrëfenja e parë: - Ja bre, kjo është Amerika!
Rrëfenja e dytë: - Kur mos kem mamanë!
Rrefenja e trete - Një nuse shqiptare rrëmbehet në Nju Jork
Rrëfenja e katërt: Një politikan i Tiranës vjen në Uashington
Rrëfenja e pestë: Takim me dy gogolat e parë sa shkel në Amerikë
Rrëfenja e gjashtë: Urat që të shpien në Menhetten
Rrëfenja e shtatë: Përse të akuzoja atëhere, or më qafsh?!
Rrëfenja e tetë: Ca fiq për një kitarë xhazi
Rrëfenja e nëntë: Si fsheha mes shalëve dyzetetremijë dollarë
Rrefenja e dhjetë: Presidenti i Amerikës apo guvernatori i Nebraskës?
Rrëfenja e njëmbëdhjetë: Në pritje për një burrë amerikan
Rrëfenja e dymbëdhjetë: çlirimi i Nju Jorkut nga gjermanët
Rrëfenja e trembëdhjetë: Hije në Filadelfia